



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 27 (827932)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 11 korrik 2025

Shqipëria forcon praninë në NATO: 30 ushtarakë nisen në mision në Bullgari deri në vitin 2028



» faqe 3



PAS ZJARRIT NË LANDFILL-IN E ELBASANIT, MINISTRAT VENGU DHE HOXHA PROPOZOJNË MASA TË REJA PËR EMERGJENCAT CIVILE

Pas zjarrit të rrezikshëm që përfshiu ditët e fundit zonën e landfill-it në Elbasan, i nxitur nga temperaturat ekstreme të kësaj vere, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, ministri i Brendshëm, z. Ervin Hoxha dhe drejtori i Përgjithshëm i AKMC, z. Haki Çako zhvilluan një inspektim të posaçëm...



faqe 3



FORMIMI I LIDERSHIPIT TË RI USHTARAK, PËRMBYLLET ME SUKSES VITI AKADEMIK NË KOLEGJIN E MBROJTJES DHE SIGURISË

Ushtria Forcon Vizionin Strategjik – KMS diplomon oficerët e rinj drejt përgatitjes shumëdimensionale. Në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua ceremonia përmbyllëse e Kursit të Lartë të Oficerit dhe Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, ku morën pjesë personalitete...



faqe 4



GUXIMI PËR TË VAZHDUAR: ZEMRA QË RREH NË UNIFORMË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Suksesi nuk është kurrë përfundimtar, dështimi nuk është kurrë fatal. Është guximi për të vazhduar ajo që ka rëndësi.” Këto fjalë, që i atribuohen Winston Churchill-it, mbartin në vetvete një filozofi që shkon përtej fjalës së bukur, ato përmbledhin esencën e qëndrueshmërisë njerëzore, por edhe më tej, përshkruajnë me përpikëri...



faqe 6

Baza e Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC) u vizitua nga ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i shoqëruar nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Altin Kurti. Vizita kishte për qëllim njohjen nga afër me kapacitetet operacionale të strukturës dhe angazhimin e efektivëve në përballimin e situatave emergjente.

Ministri Vengu vlerësoi lart investimet e realizuara gjatë dy viteve të fundit në infrastrukturë, pajisje moderne dhe trajnime të specializuara, të cilat kanë sjellë një rritje të ndjeshme të efikasitetit të bazës. “Këta janë vetëm hapat e parë drejt një modernizimi të plotë. Mbështetja e qeverisë shqiptare për këtë strukturë do të vijojë pandërprerë”, - theksoi ministri. Duke theksuar rolin strategjik të BMEC-së në sistemin kombëtar të reagimit ndaj fatkeqësive natyrore, ministri bëri të ditur se mbi 500 efektivë angazhohen çdo vit në më shumë se 50 operacione, duke dëshmuar profesionalizëm dhe përkushtim në shërbim të qytetarëve. Ai vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si një element kyç për të garantuar një reagim të koordinuar dhe efektiv ndaj çdo emergjence në kohë reale.

Në përfundim të vizitës, ministri Vengu shprehu mirënjohjen e tij për trupën e BMEC-së, duke i falënderuar për përkushtimin, sakrificën dhe besimin që i transmetojnë qytetarëve shqiptarë çdo ditë përmes punës së tyre të palodhur.



Ministri i Mbrojtjes Vengu, viziton Bazën e Mbështetjes për Emergjencat Civile: Thekson rolin kyç në reagimin ndaj Fatkeqësive



Gjeneralallejtënant Arben Kingji mori pjesë në ceremoninë e ndërrimit të Komandantit të Komandës Supreme të Aleancës në Evropë (SACEUR) në Mons, Belgjikë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në ceremoninë zyrtare të ndërrimit të komandantit Suprem të Aleancës për Evropën (SACEUR), ku gjeneral Alexis G. Grynkeuich mori detyrën në krye të Komandës së Aleancës për Operacionet (ACO) duke pasuar gjeneral Christopher G. Cavoli.

Komandanti Suprem i Aleancës për Evropën mban njëkohësisht dhe detyrën e komandantit të Forcave Amerikane në Evropë (USEUCOM). Gjeneral Grynkeuich merr detyrën në krye të ACO në një kohë kur sfidat e sigurisë për Evropën dhe NATO-n janë rritur ndjeshëm.

FARSH si anëtare e NATO-s ka një bashkëpunim të ngushtë me ACO dhe merr pjesë me personel në strukturën komanduese dhe atë të forcës, ndërkohë që me USEUCOM bashkëpunimi është në planin dypalësh dhe shumëpalësh. Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar për paqen, sigurinë dhe vlerat e përbashkëta të Aleancës dhe bashkëpunimin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Situata e Zjarreve në Vend dhe Angazhimi i Strukturave të Mbrojtjes Civile dhe FA

Zjarret përfshijnë disa qarqe – Ushtria në terren, mbi 237 forca të angazhuara në operacionet e shuarjes

Situata e zjarreve në vend mbetet e tensionuar, me disa vatra ende aktive në qarqe të ndryshme, ndërsa strukturat e Mbrojtjes Civile, Forcat e Armatosura, shërbimet zjarrfikëse dhe autoritetet vendore vijnë pa ndërprerje operacionet për izolimin dhe shuarjen e tyre.

VLORË – Vatra aktive në Orikum, ndërmjet fshatit Tragjas dhe Dukatit

Në zonën e quajtur “Sotiran”, në lartësitë malore ndërmjet fshatrave Tragjas dhe Dukat, një vatër zjarri vijon të jetë aktive në një sipërfaqe me shkurre dhe ferra. Situata është mbajtur nën monitorim gjatë gjithë natës, ndërsa gjatë ditës së sotme në terren janë angazhuar 8 forca zjarrfikëse, 4 forca bashkiake, 4 nga Shërbimi Pyjor dhe 20 trupa të Forcave të Armatosura.

DIBËR – Dy vatra zjarri në parkun Lurë dhe Zerqan

Në njësinë administrative Zerqan, bashkia Bulqizë, vatra e zjarrit në zonën pyjore “Livadhi i Peladhisë” vijon të jetë aktive, duke përfshirë një sipërfaqe prej rreth 18 hektarësh me pisha dhe dëllinja. Pritet mbërritja e rreth 25 forcave shtesë në mbështetje të operacioneve në terren.

Ndërkohë, në zonën e mbrojtur “Liqeni i Luleve” në Parkun Kombëtar Lurë, zjarri ka mbetur aktiv brenda perimetrit të tij, me intensitet të ulët. Për shuarjen e tij janë angazhuar 7 efektivë të MZSH Dibër dhe 5 forca të AdZM. Veprimet për izolimin dhe shuarjen po vazhdojnë edhe sot.

POLIÇAN & KUÇOVË – Humbje të konsiderueshme në ullinj dhe pemëtari

Rreth 2500 rrënjë ullinj të moshës mbi 10-vjeçare janë djegur në fshatin Zgërbonjë, bashkia Poliçan. Policia ka ndaluar një shtetas të dyshuar si autor i zjarrvënies. Në Kuçovë, në lagjen “11 Shkurti”, janë djegur rreth 30 rrënjë pemë frutore për shkak të këputjes së telave të tensionit të ulët.

Bilanci dhe forcat në terren

Në total janë djegur rreth 36 hektarë bimësi natyrore, përfshirë pemë, shkurre dhe barishte. Në operacionet për shuarjen e zjarreve janë përfshirë 28 automjete zjarrfikëse dhe 237 forca nga shërbimet zjarrfikëse, FA, AdZM dhe strukturat vendore. Forcat e Armatosura kanë kontribuar me 40 efektivë dhe një helikopter “Cougar”, duke ndihmuar ndjeshëm në zonat më të vështira.

Parashikimet dhe rreziku nga zjarret

Sipas Institutit të Gjeoshkencave, priten reshje të dobëta në qarqet Shkodër, Kukës dhe Elbasan, ndërsa në zona të tjera si Dibër, Durrës, Tiranë, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë, reshjet do të jenë sporadike dhe me intensitet të ulët. Niveli i rrezikut nga zjarret është “I LARTË” në qarqet Fier dhe Vlorë, “I MODERUAR” në Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Berat, Korçë dhe Gjirokastrë dhe “I ULËT” në Shkodër, Kukës dhe Dibër.

Thirrje për qytetarët

Strukturat e Mbrojtjes Civile apelojnë për bashkëpunim të plotë nga qytetarët, duke shmangur çdo veprim që mund të shkaktojë zjarr në natyrë dhe duke denoncuar menjëherë çdo vatër zjarri pranë autoriteteve. Mobilizimi i qytetarëve është thelbësor për të mbrojtur mjedisin dhe jetën e njerëzve.

Gazeta “Ushtria” – Vijnë të raportojmë në kohë reale për çdo zhvillim nga terreni.



Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për dërgimin e një toge prej 30 ushtarakësh të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Bullgari, si pjesë e grup-batalionit shumëkombësh të NATO-s, në kuadër të operacionit të Forcës së Përparuar Tokësore (Forward Land Force).

Ushtarakët shqiptarë do të vendosen në bazën e NATO-s në Novo Selo, ku do të kryejnë detyra në mbështetje të sigurisë së kufirit lindor të Aleancës në zonën përkatëse të përgjegjësisë. Misioni do të zgjasë deri më 31 dhjetor 2028, dhe do të zhvillohet me sistem rotacioni. Çdo togë do të qëndrojë për një periudhë 180-ditore, duke përfshirë edhe ditët për ndërrimin e personelit.

Ministria e Mbrojtjes do të përballojë të gjitha shpenzimet për ushtarakët pjesëmarrës, përfshirë dietat ditore prej 12,000 lekësh përveç pagës mujore, akomodimin, ushqimin, lavanderinë, sigurimin e jetës, siguracionin shëndetësor jashtë zonës së operacionit, mbështetjen shëndetësore, si dhe shpenzime për komunikim, transport dhe aktivitete social-kulturale.

Gjithashtu, Ministria e Mbrojtjes do të mbulojë transportin e personelit gjatë nisjes, kthimit dhe në rastet e veçanta si vdekja, sëmundja apo thyerjet disiplinore. Në rast të nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, shpenzimet mund të ndahen ose përballohen nga palë të tjera pjesëmarrëse në operacion.

Ky vendim shënon një tjetër angazhim konkret të Shqipërisë në kuadër të aleancës së NATO-s, duke kontribuar në sigurinë kolektive të rajonit dhe më gjerë.

Shqipëria forcon praninë në NATO: 30 ushtarakë nisen në mision në Bullgari deri në vitin 2028



Pas zjarrit të rrezikshëm që përfshiu ditët e fundit zonën e landfill-it në Elbasan, i nxitur nga temperaturat ekstreme të kësaj vere, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, ministri i Brendshëm, z. Ervin Hoxha dhe drejtori i Përgjithshëm i AKMC, z. Haki Çako zhvilluan një inspektim të posaçëm në terren për të vlerësuar situatën dhe masat e marra për menaxhimin e saj. Në këtë vizitë ishin të pranishëm edhe kryetari i Bashkisë së Elbasanit, z. Gledian Llatja, si dhe prefekti i Qarkut, z. Ilir Bejtja.

Gjatë inspektimit, ministri Vengu vlerësoi maksimalisht angazhimin e strukturave zjarrfikëse, emergjencave civile vendore, Forcave të Armatosura dhe të gjithë institucioneve të përfshira në menaxhimin e situatës. Ai theksoi se reagimi i shpejtë dhe ndërhyrja e koordinuar ndihmuan në shmangien e një katastrofe mjedisore dhe mbrojtjen e shëndetit të komunitetit lokal.

Zjarri u vu nën kontroll falë ndërhyrjes së mjeteve zjarrfikëse të ardhura nga Elbasani dhe bashkitë fqinje, si dhe përdorimit të teknologjisë moderne, përfshirë një dron që ndihmoi në monitorimin ajror dhe identifikimin e vatrave aktive. Ministri i Mbrojtjes theksoi rëndësinë e modernizimit të sistemit të emergjencave civile në vend. Ai propozoi instalimin e kamerave termike për monitorim të përhershëm në landfill-e, si dhe stacionimin e një mjeti zjarrfikës në gatishmëri të përhershme pranë tyre. “Në këtë drejtim, një zhvillim premtues është përfshirja e industrisë së mbrojtjes në prodhimin vendas të pajisjeve për emergjencat civile. Kompania shtetërore “KAYO” është duke punuar për prodhimin e mjeteve zjarrfikëse dhe pajisjeve të tjera, me synimin për të përmbushur

Pas zjarrit në landfill-in e Elbasanit, ministrat Vengu dhe Hoxha propozojnë masa të reja për emergjencat civile



nevojat kombëtare dhe për të forcuar pavarësinë teknologjike të vendit”, - deklaroi ministri Vengu.

Në përfundim të vizitës, u ritheksua nevoja për bashkëpunim ndër-institucional dhe investime në teknologji moderne për të garantuar ndërhyrje në kohë dhe për të mbrojtur sigurinë e qytetarëve.

Për këtë ngjarje është ngritur një grup pune, ku përfshihen edhe ekspertë të huaj, me qëllim realizimin e një vlerësimi të plotë të situatës dhe hartimin e një pakete masash parandaluese për të shmangur përsëritjen e rasteve të ngjashme në të ardhmen.



Ushtria Forcon Vizionin Strategjik – KMS diplomon oficerët e rinj drejt përgatitjes shumëdimensionale.

Në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua ceremonia përmbyllëse e Kursit të Lartë të Oficerit dhe Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, ku morën pjesë personalitete të larta ushtarake dhe përfaqësues diplomatikë.

Në ceremoni ishin të pranishëm: zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, ambasadori i Republikës së Kosovës, z. Skënder Durmishi, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Altin Kurti, gjeneralë, komandantë, pedagogë, si dhe vetë kursantët që përfunduan me sukses këtë cikël studimesh.

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, në fjalën e tij përshëndetëse, vlerësoi lart përkushtimin e kursantëve gjatë një viti intensiv akademik, duke theksuar rëndësinë e njohurive të përvetësuar, jo vetëm në kuadër të zhvillimit profesional, por edhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Ai nënvizoi se ky vit akademik ka qenë një hap përpara në ndërkombëtarizimin e programit të Kolegjit, me zhvillimin e moduleve të Kursit të Lartë të Oficerit në gjuhën angleze, në përputhje me standardet e NATO-s dhe aspiratat për ta shndërruar kursin në një platformë rajonale bashkëpunimi.

Një falënderim i veçantë iu adresua pedagogëve që kontribuan në realizimin me sukses të këtyre moduleve.

Në fjalën e tij, Komandanti i KMS, gjeneral brigade Ylli Pulaj vlerësoi edhe kontributin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe bashkëpunimin e shkëlqyer institucional që u reflektua në realizimin e vizitave studimore, trajnimeve dhe shkëmbimeve të përvojës. Ai theksoi rëndësinë e vijimit të këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen, përmes programeve të përbashkëta arsimore dhe akademike. Duke rikujtuar sfidat aktuale që prekin fushën e sigurisë, si inteligjenca artificiale, kërcënimet kibernetike apo teknologjitë e reja, gjeneral brigade Pulaj solli në vëmendje diskutimet e zhvilluara në Konferencën vjetore të Komandantëve të Kolegjeve të NATO-s, si një burim inspirimi për të rikonceptuar përgatitjen e liderëve të ardhshëm ushtarakë. Në përmbyllje të ceremonisë, ai shprehu mirënjohjen për stafin drejtues, akademik dhe mbështetës të Kolegjit, si dhe për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm për mbështetjen e vazhdueshme në përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe realizimin e aktiviteteve akademike.



Formimi i Leadershipit të Ri Ushtarak, Përmbyllet me Sukses Viti Akademik në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë



Ndërsa zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Abrazhda, në fjalën e saj përshëndetëse, theksoi rëndësinë e këtij kursi në leadershipin e ardhshëm ushtarak.

“Sot është një ditë krenarie dhe përkushtimi. Një moment i veçantë që kurorëzon përpjekjen, disiplinën dhe përkushtimin tuaj të palëkundur ndaj Atdheut dhe vlerave që përfaqëson uniforma që mbani me nder. Diplomimi juaj është më shumë se një arritje akademike apo profesionale. Është një dëshmi e gatishmërisë për të mbrojtur sovranitetin, paqen dhe sigurinë e vendit tonë, duke vënë në plan të parë detyrën dhe përgjegjësinë përballë çdo sakrifice personale. Ju jeni forca dhe shpresa e një ushtrie moderne, të motivuar dhe të gatshme për të përballuar sfidat e kohës, si në shërbim të kombit, ashtu edhe në misionet



ndërkombëtare, krahas aleatëve tanë.

Përpara jush qëndron një rrugë me përgjegjësi të mëdha, por edhe me nder dhe dinjitet. Ruani gjithmonë integritetin, disiplinën dhe shpirtin e shërbimit, sepse ju nuk jeni vetëm mbrojtës të kufijve tanë fizikë, por edhe të vlerave tona kombëtare

e demokratike”, - mbylli fjalën e saj znj. Abrazhda. Ceremonia u mbyll me urimet më të mira për kursantët, të cilët tashmë janë të përgatitur për të marrë role të rëndësishme drejtuese në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, të Kosovës dhe në strukturat ndërkombëtare të sigurisë.

Korab – Tre turistë shpëtohen nga Forca Ajrore me helikopter “Cougar”

Forca Ajrore Shqiptare, në bashkëpunim me ekipin mjekësor të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, realizoi një mision emergjent kërkim-shpëtimi në zonën malore të Korabit, për të shpëtuar tre turistë të helmuar si pasojë e konsumimit të bimëve të egra.

Menjëherë pas marrjes së njoftimit dhe lokalizimit të vendndodhjes së tyre, një helikopter “Cougar” u dërgua në zonë për evakuimin e menjëhershëm të turistëve. Ata morën ndihmën e parë mjekësore gjatë fluturimit drejt spitalit.

Sipas burimeve zyrtare, njëri nga turistët ndodhej në gjendje të rëndë shëndetësore, ndërsa dy të tjerët ishin në gjendje më të stabilizuara. Të tre u transportuan për trajtim të mëtejshëm në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë.

Forca Ajrore riafirmon përkushtimin e saj për të ndërhyrë në çdo situatë emergjente, duke garantuar sigurinë, mbështetjen dhe ndihmën ndaj qytetarëve në çdo cep të territorit shqiptar.



FORCAT E
Armatosura





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Suksesi nuk është kurrë përfundimtar, dështimi nuk është kurrë fatal. Është guximi për të vazhduar ajo që ka rëndësi.”

Këto fjalë, që i atribuohen Winston Churchill-it, mbartin në vetvete një filozofi që shkon përtej fjalës së bukur, ato përmbledhin esencën e qëndrueshmërisë njerëzore, por edhe më tej, përshkruajnë me përpikëri karakterin e një ushtaraku të vërtetë.

Me këtë reflektim të thellë mbi vlerat që mbartin uniforma, flamuri dhe përkushtimi ndaj Atdheut, dua të ndaj një mesazh që ndriçon rrugëtimin tonë si Forca të Armatosura të Shqipërisë, guximi për të vazhduar është arma jonë më e fortë.

Suksesi nuk është kurrë fundi, ai është fillimi i një detyre të re

Në karrierën ushtarake, shpërblimi më i madh nuk është medalja, grada apo duartrokjtja, është besimi që fitojmë nga populli ynë. Sukseset tona janë të rëndësishme, por ato nuk na japin të drejtën për të ndalur. Ato janë momente reflektimi, ringritjeje dhe përgatitjeje për sfidat që vijnë. Kurrë më shumë se sot, kur siguria kombëtare ndikohet nga dinamika globale, nga teknologjia dhe nga rreziqe të reja, nuk mund të qëndrojmë mbi lavdinë e djeshme.

Në misionet paqeruajtëse, në ndihmën ndaj komunitetit gjatë fatkeqësive natyrore, apo në ruajtjen e sovranitetit në çdo cep të territorit, çdo sukses është një etapë.

Ne nuk kemi luksin të themi “mbaruam”. Misioni ynë është vazhdimësi. Ashtu si një rojë që s’e lëshon kurrë postën, një ushtarak i vërtetë nuk pushon kurrë së shërbyeri, edhe kur lavdia është në kulm.

Dështimi, mësimi që forcon trupin dhe mendjen

Në çdo proces zhvillimi ka pengesa. Ka dështime. Por dështimi nuk është turp. Ai është një fazë e domosdoshme në formimin e karakterit ushtarak dhe njerëzor.

Nëse do të kishim frikë nga dështimi, nuk do të guxonim të ndërmerrnim asgjë. Dhe pa guxim, nuk ka përparim. Në trajnimet intensive, në ushtrimet me partnerët ndërkombëtarë, në momentet e krizave reale janë pikërisht ato gabime që bëhen shkëndija të përmirësimit. Një pajisje që dështon, një vendim i nxituar në komandë, një reagim që vonon të gjitha analizohen jo për të gjetur fajtorin, por për të forcuar sistemin.

Ushtria shqiptare ka kaluar dekada transformimi, duke u ngritur nga një e kaluar e rëndë drejt një të ardhmeje të standardeve euroatlantike. Gabimet e së shkuarës janë shndërruar në mësimet që na ndihmojnë sot të jemi më të disiplinuar, më të arsimuar, më të përgatitur. Dështimi nuk është fatal ai është i nevojshëm.

Guximi për të vazhduar, misioni që na bashkon

Nuk është vetëm trajnim fizik. Nuk është vetëm njohuri taktike. Është diçka më e thellë, është guximi që duhet të shtyjë përpara, kur forcat duket se tradhtojnë. Ky guxim shfaqet te rekrutët që lënë familjet për të shërbyer në një mjedis të panjohur. Shfaqet te komandantët që mbajnë mbi supe përgjegjësi të mëdha për jetën dhe moralin e vartësve të tyre. Është te pilotët që fluturojnë mbi territore të vështira, te zjarrfikësit ushtarakë që hyjnë në flakë, te infermierët e Forcave të Armatosura që u shërbejnë civilëve në kohë pandemie. Ky guxim nuk është thjesht ndjenjë, është identitet. Guximi për të vazhduar nuk kërkon që të mos ndjesh lodhje apo frikë. Përkundrazi, kërkon që ta pranosh dobësinë, por të mos dorëzohesh. Në këtë kontekst, forca e ushtarakut shqiptar nuk është muskulore është shpirtërore.

Historia e Kombit, një mozaik i guximit të vazhdueshëm

Shqipëria ka një histori të mbushur me përballje. Nga luftërat për liri e deri te paqeruajtjet në shekullin XXI, ne kemi treguar se populli shqiptar nuk ndalet përballë sfidave.

Ushtria ka qenë gjithmonë në ballë, në Luftën Nacionalçlirimtare, në periudhat e tranzicionit, në misionet në Afganistan, Irak, Bosnje, Kosovë, Malin e Zi, Letoni.

Në çdo faqe të historisë sonë, shfaqet një formë e guximit, guximi për të mbijetuar, për të ndërtuar nga e para, për të ecur përpara edhe kur rruga është e errët. E sot, në kohën e integritit euroatlantik, ky guxim merr forma të reja, inovacion, dijeni, partneritet, përkushtim ndaj paqes dhe stabilitetit. Ushtria jonë, më shumë se një forcë ushtarake, është garant i vlerave kombëtare. Dhe këto vlera mbijetojnë vetëm nëpërmjet guximit

Guximi për të vazhduar: Zemra që Rreh në Uniformë



Guxo për të
ARDHMEN

për të mos u dorëzuar kurrë. Më shumë se një detyrë, është një betim jetësor.

Kur një i ri apo e re vesh për herë të parë uniformën, nuk merr thjesht një vend pune. Ai merr një mision për jetë. Shërbimi ushtarak është një rrugëtim që ndryshon individin. Ai e bën më të disiplinuar, më të vetëdijshëm për përgjegjësinë qytetare dhe më të lidhur me kombin. Por më e rëndësishmja, i mëson se suksesi dhe dështimi janë kalimtarë, ndërsa guximi për të vazhduar është thelbi i çdo triumfi. Për këtë arsye, nuk ndalen stërvitjet edhe kur duket se janë të përgatitur, nuk pushojnë së përmirësuar, edhe kur vlerësohen si shembull

nga partnerët tanë në NATO. Sepse e dinë, sot është vetëm një hap drejt sfidës së nesërme.

Një thirrje për brezat e ardhshëm

Të rinj të dashur: mos kini frikë nga sfidat, zgjidhni guximin për të vazhduar në jetë, në karrierë, në atdhedashuri. Ushtria është një shkollë karakteri, një komunitet nderi dhe një familje që nuk të braktis kurrë.

Dhe për të gjithë ata që sot mbajnë uniformën, mos harroni kurrë pse e nisët këtë rrugë. Le të na udhëheqë gjithmonë guximi për të vazhduar përpara, sepse ky guxim është ai që ndërton paqen, mbron sovranitetin dhe mban lart dinjitetin tonë kombëtar.



Gjeopolitika në Shekullin XXI: Ndikimet, Sfidat dhe Perspektivat Globale

Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe dinamike, gjeopolitika ka marrë një rol të pazëvendësueshëm në formësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe vendimmarrjes globale. E përkufizuar si ndërveprimi midis gjeografisë, politikës dhe pushtetit, gjeopolitika shkon përtej kufijve tradicionalë të diplomacisë për të analizuar ndikimin e faktorëve natyrorë, ekonomikë, ushtarakë dhe teknologjikë në sjelljen e shteteve. Shekulli XXI ka sjellë ndryshime thelbësore në strukturën e rendit botëror me shfaqjen e aktorëve të rinj, luftërat hibride, krizën klimatike dhe transformimin e fuqisë ekonomike drejt Lindjes.

Fuqitë e Mëdha dhe Riorganizimi i Rendit Botëror

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dolën si superfuqia e vetme globale, duke vendosur një rend të ri liberal dhe demokratik të bazuar në tregjet e lira, të drejtat e njeriut dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Megjithatë, dekadat e fundit kanë dëshmuar një lëvizje graduale drejt një bote multipolare. Kina, e cila ka përjetuar një rritje të jashtëzakonshme ekonomike dhe ushtarake, ka filluar të sfidojë dominimin amerikan në rajonin e Indo-Paqësorit dhe më gjerë. Iniciativa “Një Brez, Një Rrugë” (Belt and Road Initiative) është një shembull i përpjekjeve kineze për të zgjeruar ndikimin e saj në Afrikë, Azi dhe Evropë përmes investimeve strategjike.

Nga ana tjetër, Rusia ka ndërmarrë një qasje agresive për të rikthyer statusin e saj si fuqi globale, duke përdorur energjinë si armë politike dhe duke ndërhyrë ushtarakisht në rajone si Gjeorgjia, Krimea dhe Ukraina. Këto veprime e kanë përplasur Kremlinin me Perëndimin dhe kanë rindezur ndasitë midis sferave të ndikimit lindor dhe perëndimor.

Luftërat Hibride dhe Dimensioni i Ri i Konfliktit

Ndryshe nga luftërat tradicionale të shekujve të kaluar, përballjet e sotme nuk zhvillohen vetëm në fushëbetejë. Termi “luftë hibride” përshkruan një strategji që kombinon mjetet ushtarake, kibernetike, ekonomike dhe informative për të arritur qëllime strategjike pa një luftë të hapur. Rusia ka përdorur këtë model me sukses në Ukrainë dhe në përpjekjet për të ndikuar zgjedhjet në vendet perëndimore.

Sulmet kibernetike, përhapja e dezinformimit në rrjete sociale dhe manipulimi i opinionit publik, janë bërë pjesë e armëve të reja të fuqive gjeopolitike. Në këtë kontekst, edhe demokracitë më të konsoliduara janë të cenueshme nga ndikimet e jashtme.

Ekulibrat Ekonomikë dhe Politika Ndërkombëtare e Energjisë

Energjia ka qenë gjithmonë një faktor thelbësor në gjeopolitikë. Vendet prodhuese të naftës dhe gazit kanë pasur shpesh një avantazh strategjik në negociatat ndërkombëtare. Rusia, për shembull, ka përdorur varësinë energjetike të Evropës si një mjet presioni politik. Në anën tjetër, tranzicioni drejt energjisë së pastër dhe lufta kundër ndryshimeve klimatike po riformësojnë hartën energjetike globale. Vendet që zotërojnë



burime të pastra si litiumi dhe hidrogjeni po fitojnë rëndësi të re gjeopolitike.

Ndërkohë, ndikimi ekonomik i Kinës është forcuar ndjeshëm, duke e bërë atë kreditorin më të madh të shumë vendeve në zhvillim. Kjo i jep Pekinit një mjet të fuqishëm për të ushtruar ndikim në vendime politike dhe ekonomike në rajone të tëra.



Ballkani dhe Shqipëria në Kontekstin Gjeopolitik

Ballkani, një rajon i ndërlidhur historikisht dhe politikisht, mbetet një nga zonat më të ndjeshme gjeopolitike të Evropës. Me një të kaluar të përgjakshme, rajoni është sot një fushë loje për ndikimin e BE-së, SHBA-së, Kinës, Turqisë dhe Rusisë.

Shqipëria, si një vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për Bashkimin Evropian, ka pozicion strategjik në stabilitetin rajonal.

Për Shqipërinë, siguria dhe integrimi evropian janë prioritet kombëtar. Megjithatë, vendi duhet të ruajë një balancë të kujdesshme ndërmjet investimeve të huaja dhe ruajtjes së sovranitetit politik. Ndikimi i Kinës në Ballkan përmes kredive dhe projekteve infrastrukturore duhet të vlerësohet me kujdes, për të mos u bërë pjesë e varësive të rrezikshme ekonomike.

Ndryshimet Klimatike si Sfidë Gjeopolitike

Ndryshimet klimatike nuk janë më vetëm një çështje mjedisore, ato janë kthyer në një faktor të rëndësishëm gjeopolitik. Shkrirja e akullnajave në Arktik ka hapur rrugë të reja detare dhe ka zbuluar burime natyrore të paprekura, duke nxitur garë midis fuqive për kontrollin e këtyre territoreve. Mungesa e ujit, thatësisirat dhe migrimi i popullsisë nga zonat e prekura po krijojnë tensione të reja ndërkombëtare. Vendet që nuk janë të përgatitura për pasojat e ndryshimeve klimatike do të përballen me destabilizim të brendshëm, ndërsa ato që zotërojnë teknologji dhe zgjidhje për energji të qëndrueshme do të fitojnë avantazh global.



Gjeopolitika në shekullin XXI është më komplekse, më dinamike dhe më e ndërlidhur se kurrë më parë. Me shtete që përpiqen të zgjerojnë sferën e tyre të ndikimit përmes strategjive hibride, ndikimit ekonomik dhe teknologjisë së avancuar, rendi ndërkombëtar është në transformim të vazhdueshëm. Në këtë kontekst, edhe vende të vogla si Shqipëria duhet të jenë të vetëdijshme për ndikimet globale, të ndërtojnë politika të mençura dhe të bashkëpunojnë ngushtë me aleatët për të ruajtur stabilitetin dhe pavarësinë.

Gjeopolitika nuk është më një lojë për “të mëdhenjtë”, ajo ndikon mbi jetën e përditshme të çdo qytetari në çdo cep të globit.



KOLONEL (R) ARBEN DHULI

“Ushtria marshon mbi stomakun e saj” – thotë Napolon Bonaparti, pasi ajo përfshin furnizimin me ushqim, karburant, municione, armatime dhe pajisje si dhe lëvizshmërinë dhe transportin e forcave, duke siguruar që njësitë ushtarake mund të veprojnë në kushte të ndryshme dhe gjatë periudhave të ndryshme kohore. Roli i logjistikës në çdo komb por edhe në NATO është thelbësor për sigurimin e suksesit të operacioneve të aleancës, veçanërisht në kontekste, ku mund të ketë mungesë mbështetjeje direkte nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). NATO, si një aleancë ndërkombëtare e përbërë nga shtete anëtare me kapacitete dhe nevoja të ndryshme, përballlet me sfida të mëdha logjistike për të ruajtur qëndrueshmërinë operative dhe për të siguruar efikasitetin në misionet e saj. Varësia nga logjistika ushtarake e SHBA-ve, pasi ato janë një prej kontribuuesve kryesorë në logjistikën e NATO-s, duke ofruar kapacitete të mëdha transporti, mbështetje teknike dhe mjetet e nevojshme për operacione. Kur kjo mbështetje nuk është e disponueshme, NATO duhet të sigurojë që shtetet e tjera anëtare të kenë kapacitete të mjaftueshme për të mbajtur operacionet aktive. Kombinimi i kapaciteteve të ndryshme, pasi shtetet anëtare të NATO-s kanë kapacitete të ndryshme logjistike, duke përfshirë teknologji, infrastrukturë dhe burime njerëzore. Sigurimi i një niveli të lartë koordinimi midis këtyre kapaciteteve është një sfidë, veçanërisht kur ka mungesë mbështetjeje të përbashkët ose të centralizuar.

Përshtatja me mjedisin dinamik është një tjetër sfidë, pasi NATO është e angazhuar në një mori operacionesh, nga ato ushtarake deri tek misionet e paqes dhe stabilizimit, si rezultat edhe nevojat logjistike ndryshojnë nga një mision në tjetrin. Pa një mbështetje amerikane, kërkesa për fleksibilitet dhe adaptim në përdorimin e resurseve dhe kapaciteteve është më e madhe. Infrastruktura dhe rrugët e komunikimit dhe lidhjet e dobëta infrastrukturore ndërmjet vendeve të ndryshme të NATO-s mund të çojnë në vonesa dhe mungesë të shpejtësisë në mobilizimin e burimeve logjistike. Po ashtu, çështjet e sigurisë dhe ndjeshmëria ndaj sulmeve kibernetike kanë bërë që infrastruktura e komunikimit të bëhet një komponent kritik. Koordinimi më i fortë midis shteteve anëtare, pa mbështetje direkte nga SHBA-të, kërkon që NATO të investojë më shumë në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të krijojë struktura të centralizuara për menaxhimin e burimeve logjistike, që do të mundësojnë më shumë koordinim dhe efikasitet në operacione. NATO është një aleancë ndërkombëtare, dhe logjistika është shumë komplekse për shkak të diversitetit të shteteve anëtare, çdo vend ka kapacitete dhe infrastrukturë të ndryshme. NATO ka zhvilluar struktura të specializuara për të siguruar që të gjitha shtetet e aleancës të mund të punojnë së bashku. Megjithatë, kjo kërkon koordinim të vazhdueshëm dhe ndihmon që mjetet dhe burimet të përdoren në mënyrë efikase. Shtetet anëtare të NATO-s duhet të zhvillojnë aftësi të pavarura logjistike për të siguruar që operacionet të mos varen nga një fuqi e jashtme. Kjo mund të përfshijë investime në infrastrukturën e transportit, zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të burimeve dhe trajnimin e personelit për të operuar në kushte të ndryshme. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një rol të rëndësishëm në logjistikën e NATO-s për shkak të kapaciteteve të tyre të jashtëzakonshme dhe burimeve të disponueshme. Ata janë përgjegjës për shumë nga kapacitetet e transportit si avionët dhe anijet, dhe për sigurimin e mbështetjes në terren. Për të siguruar qëndrueshmërinë operative, është e domosdoshme të krijohen mekanizma të shpejtë dhe efikasë për shpërndarjen e burimeve logjistike, veçanërisht për furnizimet kritike si karburanti, municionet dhe pajisjet shëndetësore. Kapacitetet e transportit dhe furnizimit: NATO ka ngritur një sistem të integruar transporti dhe furnizimi për t'u siguruar që operacionet mund të zhvillohen pa ndërprerje. Ky sistem përfshin rrugë ajrore, detare dhe tokësore/hekurudhore. Megjithatë, një problem është se shumë shtete aleate janë më të kufizuara në kapacitetet e tyre logjistike, duke e bërë logjistikën e SHBA-ve një pjesë të rëndësishme. Pa mbështetje të drejtpërdrejtë nga SHBA-të, NATO duhet të forcojë masat e sigurisë në nivele të ndryshme të logjistikës. Ky përforsim mund të përfshijë avancimin e teknologjive për mbrojtjen e rrjeteve logjistike dhe

Europa pa mbështetjen logjistike amerikane, sfidë dhe mundësi



krijimin e sistemeve të mbështetjes në kushte të emergjencave. Sfidat logjistike me të cilat përballlet NATO pa mbështetje të drejtpërdrejtë nga SHBA-të janë të mëdha, por gjithashtu ofrojnë mundësi për përmirësim dhe rritje të pavarësisë së aleancës. Për të ruajtur qëndrueshmërinë operative, NATO do të duhet të investojë në bashkëpunim të ngushtë midis shteteve anëtare, zhvillimin e aftësive të pavarura logjistike dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe teknologjisë. Pas një periudhe të adaptimit dhe integritit të mëtejshëm, aleanca mund të arrijë një nivel të lartë pavarësie dhe fleksibiliteti në operacionet e saj logjistike. Vlerësimi i logjistikës së NATO-s është një aspekt thelbësor i operacioneve të Aleancës, pasi logjistika siguron mbështetje të qëndrueshme dhe efikase për misionet e NATO-s, që nga operacionet ushtarake deri te ndihma humanitare dhe operacionet paqeruajtëse. Logjistika e NATO-s është shumëdimensionale dhe ka për qëllim të sigurojë furnizimin e nevojshëm, transportin, mbështetjen dhe miradministrimin e burimeve për të siguruar që ushtarët dhe materialet të jenë të gatshëm dhe në dispozicion për çdo operacion të mundshëm. NATO përbëhet nga shtete anëtare që operojnë sipas standardeve dhe sistemet të ndryshme logjistike. Një nga sfidat më të mëdha është integrimi i këtyre sistemeve dhe siguria e ndërveprimit të tyre për të siguruar që operacionet të jenë të njëpasnjëshme dhe të shpejta. Ky bashkëpunim dhe koordinim është një nga faktorët kyç që ndihmon në suksesin e operacioneve të NATO-s. Logjistika e NATO-s kërkon një planifikim të detajuar për çdo operacion, duke përfshirë përcaktimin e burimeve të nevojshme, si dhe planifikimin për transportin dhe shpërndarjen e materialeve. Përveç kësaj, ka nevojë për një koordinim të ngushtë me vendet mikpritëse dhe organizatat ndërkombëtare të tjera, si Kombet e Bashkuara

ose Bashkimi Evropian, kur operacionet janë të përbashkëta.

Përdorimi i teknologjisë moderne, si sistemet e menaxhimit të inventarit dhe logjistikës përmes mjeteve të avancuara të informacionit dhe telekomunikacionit, ka lejuar përmirësimin e efikasitetit të logjistikës në NATO. Të dhënat e sakta dhe në kohë reale janë të domosdoshme për të siguruar që materialet të arrijnë në destinacionin e duhur pa vonesa të panevojshme. Infrastruktura logjistike e NATO-s është e përhapur dhe e adaptuar për të mbështetur një gamë të gjerë operacionesh, nga ato të shkallës së vogël deri tek operacionet ndërkombëtare të mëdha.

Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës është i domosdoshëm për të mbajtur një nivel të lartë efikasiteti dhe për të siguruar që logjistika të mund të përballojë ngarkesat e operacioneve të ndryshme. Logjistika e NATO-s duhet të jetë e aftë të adaptohet ndaj çdo lloj terreni dhe kushtesh të ndryshme. Operacionet e NATO-s mund të ndodhin në kushte ekstreme, përfshirë zona të pasigurua, klimë të keqe dhe terrene të vështira. Kjo kërkon shtrirje dhe fleksibilitet në mundësinë për të siguruar mbështetje për ushtarët dhe misionet. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është siguria e proceseve logjistike, duke përfshirë mbrojtjen e furnizimeve dhe infrastrukturës nga sulmet e mundshme ose ndërhyrjet. NATO ka zhvilluar sisteme të avancuara për të siguruar që burimet logjistike të jenë të mbrojtura dhe të menaxhuara në mënyrë efikase, duke shmangur humbjet e mundshme. Përfundimisht, logjistika e NATO-s është një element kyç për mbështetje dhe sukses të operacioneve të Aleancës, dhe proceset e saj vazhdojnë të përmirësohen dhe përshtaten në përputhje me kërkesat dhe sfidat moderne të sigurisë globale. A mund të kemi qëndrueshmëri operacionale pa logjistikën amerikane?

Në teorinë e një operacioni të shkallës më të gjerë, pa



mbështetje të logjistikës amerikane, do të ishim në një situatë më të vështirë për të ruajtur qëndrueshmërinë operationale, sidomos kur bëhet fjalë për misione afatgjata dhe të largëta. Qëndrueshmëria operationale pa logjistikën amerikane do të varej shumë nga natyra e operationeve dhe burimet e tjera të mundshme që mund të përdoren. Në shumë raste, ku logjistika amerikane është e integruar thelbësore për operatione të mëdha ushtarake dhe civile, duke ofruar mbështetje të konsiderueshme në furnizime, transport, dhe mbikëqyrje të materialeve dhe të forcave. Megjithatë, është e mundur që një forcë ose organizatë të arrijë qëndrueshmëri operationale pa këtë mbështetje, por kjo kërkon planifikim të kujdesshëm dhe burime të tjera. Nëse një forcë ose organizatë është në gjendje të menaxhojë burimet e veta logjistike dhe të sigurojë furnizime nga burime të tjera (p.sh., nga partnerë ndërkombëtarë, burime lokale, ose përmes rrugëve alternative të furnizimit), atëherë mund të ketë mundësi për të mbajtur operationet në vazhdimësi. Megjithatë, kjo mund të kërkojë një nivel të lartë të specializimit në menaxhimin e logjistikës dhe një organizim të mirë të burimeve, që mund të jetë shumë më i vështirë pa mbështetje të jashtme të mëdha, siç është ajo amerikane. Disa shtete anëtare të NATO-s kanë kapacitete të mira logjistike dhe mund të ofrojnë mbështetje për operatione më të vogla ose më të fokusuar. Megjithatë, shumica e shteteve janë të varura nga kapacitetet amerikane, si për transportin e shpejtë, ashtu edhe për mbështetje teknike. Pa logjistikën amerikane, mund të kishte vonesa dhe mungesë në furnizim me municione dhe materialet e tjera të nevojshme, veçanërisht në një shkallë të gjerë operationale. Kjo mund të dëmtonte efikasitetin e operationeve të NATO-s dhe të rrisë kostot e përfshira. Me zhvillimin e infrastrukturave dhe kapaciteteve të tjera logjistike, shtetet aleate mund të përpiqen të krijojnë burime të tjera të furnizimit dhe mbështetjes. Kjo mund të përfshijë investime në infrastrukturë më të sofistikuar të transportit, krijim sistemesh të tjera të magazinimit dhe rritjen e kapaciteteve të operationeve të brendshme. Pra logjistika amerikane është e rëndësishme për qëndrueshmërinë e operationeve të NATO-s, veçanërisht për shkallën e tyre të madhe si dhe misionet afatgjata. Si përfundim, megjithatë pa këtë mbështetje, NATO mund të operojë, por do të kishte sfida të mëdha në aspektin e efikasitetit dhe shpejtësisë së operationeve, sidomos në misionet që kërkojnë mbështetje logjistike të avancuar. Për të siguruar një qëndrueshmëri më të lartë, NATO duhet të investojë në zhvillimin e kapaciteteve të tjera logjistike dhe të rrisë më tej bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare.

Natyrshëm lind pyetja: A mundet Evropa të rekrutojë trupa për të penguar Rusinë pa ndihmën e SHBA-ve? Një pyetje e cila është komplekse dhe varet nga disa faktorë politikë, ushtarakë dhe ekonomikë. Megjithatë, disa argumente mund të shqyrtohen për të analizuar mundësitë: Evropa ka disa ushtri të fuqishme, përfshirë ato të vendeve si Franca, Gjermania, dhe Mbretëria e Bashkuar (para Brexit, ishte një partner i fuqishëm në strukturat e mbrojtjes evropiane). Por, këto ushtri nuk janë gjithmonë të bashkërenduara dhe nuk kanë një nivel të barabartë kapacitetesh për të përballuar një

kërcënim të madh, siç është Rusia. Një nga pengesat kryesore është se shumica e vendeve evropiane kanë shpenzime të kufizuara për mbrojtjen dhe nuk janë të gatshme të angazhohen në operatione të mëdha ushtarake pa mbështetje nga aleatët. NATO është një strukturë e rëndësishme ushtarake dhe politike e udhëhequr nga SHBA-të, por që përfshin edhe shumë shtete evropiane. Pavarësisht se Evropa mund të mobilizojë trupa, shumica e vendeve evropiane janë të angazhuara në NATO dhe varet nga rregullat e aleancës për të ndërhyrë. Nëse SHBA-ja nuk do të ishte e përfshirë, aleatët evropianë mund të kishin disa shqetësime për kapacitetin për të përballuar një kërcënim të tillë pa mbështetje të mëtejshme nga fuqia e SHBA-së, sidomos në fushën e teknologjisë dhe mbështetjes ajrore. Evropa është një kontinent me politika të ndryshme dhe interesa të ndryshme, disa shtete mund të kenë interesa të ndryshme nga të tjerat, duke e bërë të vështirë marrjen e vendimeve të shpejta dhe të koordinuara për të angazhuar trupa të mëdha. Po ashtu, shumë shtete evropiane preferojnë të shmangin përfshirjen në konflikte të mëdha dhe mund të kenë nevojë për mbështetje të SHBA-së për të justifikuar një angazhim të tillë. Një nga shqetësimet kryesore në lidhje me përfshirjen e trupave evropiane është mundësia e eskalimit të një lufte të madhe me Rusinë. Pa mbështetje të SHBA-së, evropianët mund të ndihen të pasigurt dhe të kufizuar në mundësinë e një operacioni të gjerë. Vlerësimi i logjistikës së NATO-s është një aspekt thelbësor për sigurinë dhe funksionimin e Aleancës, përveç armatimit dhe municioneve të nevojshme, pasi logjistika është ajo që mundëson mbështetje për operationet ushtarake në misionet e NATO-s. Në përfundim, ndonëse Evropa ka kapacitetin për të rekrutuar dhe angazhuar trupa, përpjekja për të penguar Rusinë pa mbështetje nga SHBA-të do të ishte shumë e vështirë dhe do të kërkonte një nivel të lartë bashkëpunimi dhe koordinimi, si dhe angazhim më të madh financiar dhe ushtarak nga vendet evropiane. Pas Luftës së Ftohtë, vendet evropiane zvogëluan sistematikisht ushtritë e tyre, me lojtarët kryesorë si Franca që pezulluan rekrutimin dhe pësuan një rënie përkatëse në madhësinë e forcave të saj të armatosura - me 38% nga vitet 1990 deri më sot.

Vetëm Austria, Qipro, Danimarka, Estonia, Finlanda, Greqia, Norvegjia, Zvicra dhe Turqia nuk e pezulluan asnjëherë shërbimin aktiv. Një sondazh i “Gallup” i kryer vitin e kaluar (2024) zbuloi se vetëm 32% e qytetarëve të BE-së do të ishin të gatshëm të mbronin vendin e tyre në rast lufte. Në ekonomitë kryesore të BE-së si Italia, Gjermania dhe Spanja, shifrat ishin edhe më të ulëta, ku vetëm 14% e italianëve, 23% e gjermanëve dhe 29% e spanjollëve deklaruan se do të ishin të gatshëm të luftonin për vendin e tyre në rast lufte. Dr. Alexandr Burilkov, studiues në Universitetin Leuphana të Luxenburg deklaroi se: “Tani, gjëja më urgjente është në thelb të kesh trupa të mjaftueshme për të mbajtur vijën, jo domosdoshmërisht për të luftuar rusët, por për të dërguar një mesazh të fortë parandalues”. Ky mesazh do të thotë: “Nëse provoni atë që bëtë në shkurt të vitit 2022, nuk do të ketë sukses”. Burilkov është një nga bashkautorët e një analize të përbashkët nga “think-tank

Bruegel” dhe Instituti Kiel, i cili vlerëson se Evropës do t’i nevojiten rreth 300,000 trupa shtesë për t’u mbrojtur, në krye të 1.47 milion personel aktual ushtarak aktiv, përfshirë ata në Mbretërinë e Bashkuar. “Në dy vitet e fundit, rusët e kanë vendosur ekonominë dhe shoqërinë e tyre kryesisht në një bazë lufte”, tha Burilkov, duke shtuar se “kur bëhet kolektivisht, rritja e aftësive mbrojtëse nuk është një shpenzim i parealizueshëm, veçanërisht duke marrë parasysh pasojat”. Aleatët e NATO-s aktualisht po diskutojnë se si ta bëjnë këtë, si në aspektin e pajisjeve dhe personelit ushtarak dhe rekrutimi është pjesë e debatit, tha një zyrtar i NATO-s për “Euronews”, duke shtuar se për të siguruar mbrojtje efektive kolektive në mjedisin aktual, nevojiten më shumë forca për të realizuar planet e mbrojtjes të aleancës. Si të gjenerohen këto forca, nëse do të përdoret sistemi i rekrutimit, forcat rezervë apo ndonjë model tjetër, është një vendim sovran kombëtar i marrë nga aleatët. Aleanca ushtarake transatlantike nuk mandaton politikat ushtarake kombëtare, por mund të luajë një rol në përcaktimin e një sinjali kërkeje dhe lehtësimin e

shkëmbimeve ndërmjet aleatëve. Debatet mbi praktikat më të mira, mësimet e nxjerra dhe rolin e mundshëm të NATO-s në adresimin e sfidave të rekrutimit dhe mbajtjes do të ngrihen në axhendën e aleancës në muajt e ardhshëm. Pas agresionit ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës, shtetet baltike si Letonia dhe Lituania kanë zbatuar modele të ndryshme rekrutimi për të zgjeruar forcat e tyre të armatosura. Kroacia gjithashtu planifikon të rifusë shërbimin e detyrueshëm ushtarak këtë vit dhe më shumë vende mund të pasojnë, pasi shërbimet e inteligjencës paralajmërojnë për një sulm të mundshëm rus ndaj një shteti anëtar të NATO-s brenda pesë viteve dhe pasiguria rritet mbi angazhimin e Donald Trump ndaj NATO-s dhe sigurisë evropiane. Finlanda dhe Estonia kanë shërbimin e detyrueshëm ushtarak, ndërsa Danimarka, Lituania dhe Letonia përdorin një sistem rekrutimi të drejtuar nga lotaria; Norvegjia dhe Suedia e kanë shërbimin e detyrueshëm selektiv. Nuk ka një zgjidhje të vetme për të gjithë, por studiuesit e “Carnegie Europe” argumentuan në një dokument politikash të vitit 2024 se mund të nxirren mësim nga shtetet nordike dhe baltike. Këto vende kanë prezantuar stimuj të ndryshëm për ta bërë shërbimin ushtarak më tërheqës, duke përfshirë përfitime financiare dhe mundësi punësimi. Lituania, për shembull, ofron mbështetje financiare dhe logjistike për ata që i bashkohen vullnetarisht shërbimit, si dhe punësim dhe ndihmë arsimore gjatë dhe pas detyrës ushtarake. Dhe Forcat e Mbrojtjes së Estonisë punojnë me punëdhënësit privatë në programe të tilla si Rekrutimi Kibernetik i Forcave, ku ata i dërgojnë punonjësit e tyre në shërbimin kibernetik për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe më pas i aplikojnë në punët e tyre. “Nga disa struktura ushtarake po shikohet mundësia se si të kalojnë një lloj procesi të rishqyrtimit se cilat role duhet të jenë ushtarake dhe cilat role duhet të jenë civile, sepse natyra e luftës dhe e sigurisë kombëtare po ndryshon”, shkruan Linda Slapakova, studiuese në “RAND Europe”. Megjithatë, jo të gjithë janë dakord mbi nevojën për të rikthyer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, një opsion ligjërisht i pamundur në disa vende dhe politikisht i pabesueshëm ose praktikisht i pamundur në të tjera. “Duke parë vetëm ushtrinë, kërkohet shumë për sa i përket infrastrukturës së trajnimit, logjistikës së nevojshme, marrjes së njerëzve përmes kontrolleve mjekësore dhe regjistrimin e njerëzve për të kryer stërvitjen dhe shërbimin e tyre”, tha Slapakova për “Euronews”, duke theksuar se kjo lloj infrastrukture nuk ekziston në shumë vende. Nëse qëllimi është vetëm përmirësimi i aftësive dhe logjistikës së forcave të armatosura, mendoj se ka shumë çështje të tjera që vendet mund të shikojnë përpara se të fillojnë të marrin në konsideratë diçka si rekrutimi i të rinjve për t’u bashkuar me shërbimin ushtarak ose civil. Për të pasur një ushtri elastike/fleksibël dhe me një mbështetje logjistike të plotë, edhe për forcat tona nuk duhet të zgjedhim vetëm fazat e fillimit të konfliktit, por duhet të vazhdojmë edhe fazat e tjera të luftimit, nëse është e nevojshme, me qëllim që të jemi në gjendje të prezantojmë një lloj sistemi që do të rriste sasinë e personelit në dispozicion, si dhe një logjistikë të fuqishme që do të rrisë fuqinë e bashkëpunimit me Aleancën.

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve**Trashëgimia e pashkruar: rrënjët e një gruaje**

Në fillim të gjithçkaje, është zëri i nënës. Një zë që s’ka nevojë të bërtasë për t’u dëgjuar, sepse ndjehet në çdo shtresë të shpirtit. Në zërin e saj fshihet sakrifika, durimi dhe një dashuri që tejkalon fjalët. Ashtu si shumë vajza shqiptare, edhe unë jam rritur nën hijen e një gruaje që nuk foli për veten, por e rrëfeu jetën e saj nëpërmjet veprave.

Nuk është e lehtë të rritesh me një peshë që nuk e kupton menjëherë. Peshë e gjeneratave, e “duhet”-ëve të pashkruara, e heshtjeve që flasin më shumë se çdo ligjëratë. Nëna ime, zonjë shtëpie dhe profesioniste, përthithte gjithçka: ethet e stinëve, detyrat e punës dhe ritualet e përditshmërisë, që shpesh e gjenin të përkulur mbi furnelat me vajgur, me duar të djegura, me një buzëqeshje që fshehte lodhjen. “Gruaja duhet të dijë të durojë”, thoshte ajo. Dhe unë e besoja, për një kohë.

Por midis gjithë asaj që duronte, në sytë e saj kishte një dritë të çuditshme – një shkëndijë rebelimi të heshtur që refuzonte t’i nënshtrohej plotësisht një bote që kërkonte nënshtrim. Kjo dritë më ndihmoi të kuptoj se, po, mund të trashëgojmë vuajtje, por mund të trashëgojmë edhe forcën për t’i përmbysur ato.

Nga vajzë në grua, udhëtimi përmes**zgjedhjeve dhe dyshimeve**

Rrugëtimi im nga një vajzë e vogël në një grua është shkruar në hije dhe dritë, në ndalesa të detyruara dhe në fluturime të guximshme. Kam jetuar në kufirin midis asaj që “duhet të jem” dhe asaj që “dua të jem”. Në një shoqëri ku vajzat nuk ngjiten në pemë dhe gratë duhet të bëjnë gjithçka në heshtje, çdo zgjedhje e imja është një akt revolucionari.

Jam rritur duke ndjerë që çdo hap më largohet nga modelet e së kaluarës, por gjithmonë me një kordon të padukshëm që më lidhte me to. Kam zgjedhur të ndërtoj familje, jo si një model të imponuar, por si një mision të vetëdijshëm, ku përfshihen të gjithë familjarët bashkë si një qelizë e vogël dashurie që sfidon botën.

Dhe në çdo zgjedhje, edhe në ato që nuk ishin të sigurta, jam rritur. Sepse të jesh grua do të thotë të përballësh me dyshimin, me frikën, me peshën e të panjohurës, dhe megjithatë të ecësh përpara.

Si vajzë mbaj peshën e trashëgimisë, përvojat dhe mësimet që më janë përcjellë, si ato të dashurisë ashtu edhe ato të dhimbjes. Çdo gjest i prindërve të mi ka formuar një pjesë të timen, edhe kur nuk e kuptoja plotësisht kuptimin e tyre. Kujtoj nënën time, me sakrificën e një zonje shtëpie, që përveç profesionit, përkushtohet maksimalisht të bënte më të mirën për ne. Të na përgatiste vaktin, përkulur mbi furnelat e zjarrit me vajgur, ku duart e saj përfundonin edhe të lënduara. “Gruaja duhet të dijë të durojë,” më thoshte ajo, ndërsa me nxitimin e të bërit shpejt çdo gjëje, e gjenim të lodhur në tryezë, pa mundur të konsumonte vaktin e saj. Në sytë e saj gjeja një shkëndijë rebelizmi, si një përgjigje e heshtur ndaj urdhrave të botës. Unë jam bija e saj. Kam ecur në kufirin midis “duhet” dhe “dua”. Kam mësuar shumë prej saj, nga një vajzë e vogël, e ndaluar të ngjitej në pemë, sepse “nuk është punë për vajza”, në një grua që zgjodhi të ndërtojë familjen ashtu siç na edukoi, me misionin e shenjtë ku bëhen bashkë nëna, babai dhe vëllai. Çdo hap i imi ka qenë një betim i padëgjuar, ndaj sot unë ekzistoj duke marrë vendime që ma bëjnë një botë edhe më të thjeshtësuar. Ma mësoi nëna ime udhën. Çdo fjalë e mbetur, e pathënë prej



saj, është një histori që e mbaj me vete, në kujtesën e asaj që kam qenë dhe kush vazhdoj të jem.

Sot, si nënë, zemra ime zgjerohet përtej çdo kufiri të njohur, më duket se duhet të jem gjithçka për dikë, duhet të jap pa llogaritur kurrë, të jap pa kërkuar asgjë në këmbim.

Të jesh nënë, nuk do të thotë vetëm të mbrosh, do të thotë gjithashtu të mësosh elasticitetin, bukurinë e zgjedhjes, forcën për të rënë dhe për t’u ngritur përsëri. Dhe këto i mëson teksa rrit dhe rritesh bashkërisht me fëmijët e tu, ku dhe gjinia e ndryshme e tyre përbën një mësim më vete. Iu dukesh si busull e njëherësh si orakull shpëtimi për zgjidhjet që ua ofron si leksione jete. Jam rrënjë dhe krah. Pikërisht ashtu si nëna ime ka qenë për mua. Dhe, në vetminë e netëve pa gjumë ose në mes të furisë së përditshmërisë, kam zbuluar se të qenët nënë është gjithashtu një akt lirie dhe ndërgjegjësimi.

Si grua, e gjej veten të jem ajo që shohin të tjerët dhe ajo që unë zgjedh të jem. Çdo pritshmëri sociale më prek, por nuk më përcakton. Unë jam bërë nga njëmijë nuanca, nga zgjedhjet e bëra me guxim dhe nga dyshimet që më bëjnë më njerëzore.

Të jesh grua në botën e sotme?!

Në botën moderne, të jesh grua është si të ecësh në një fije të hollë të baraspeshës. Je e ngarkuar me pritshmëri, të jesh e bukur por jo shumë, e zgjuar por jo kërcënuese, nënë, bashkëshorte, profesioniste, e fortë, por jo arrogante. Dhe në këtë vorbull rolesh, rrezikon të humbësh thelbin tënd.

Por nuk dua të ndaloj së qeni ajo që zgjedh të jem. Çdo lot i derdhur është shenjë njerëzimi, jo dobësie. Çdo kthesë që marr pa leje është shenjë guximi, jo gabimi. Të jesh grua nuk është vetëm një rol, është një thirrje për të ndriçuar, për të prekur, për të ndryshuar, për të qenë.

Unë e pranoj dualitetin tim, jam ajo që më shohin dhe ajo që vetëm unë e njoh. Dhe pikërisht aty, në atë përplasje botësh, mësoj të jem më e vërtetë se kurrë.

Premtimi i pashkruar: Gruaja si fjalor**i një gjuhe që ende po shkruhet**

“Jam grua”, nuk është as sfidë dhe as thirrje. Është një premtim. Një rrëfim që nuk përfundon me mua, por nis prej meje. Çdo hap që bëj sot është për nënën time, për gratë para saj dhe atyre pas. Unë nuk dua t’i ndryshoj botës trajtën, por dua të mbjell një kopsht në çdo cep të saj, aty ku gratë e së kaluarës nuk patën mundësi të lëshonin rrënjë.

Sepse ne, gratë, jemi fjalori i një gjuhe që ende po shkruhet. Një gjuhë e dashurisë, sakrificës, forcës dhe butësisë. Në këtë botë që na kërkon të jemi gjithçka, ndoshta sekretin nuk qëndron te të bërit gjithçka për të tjerët, por te mos-humbja e vetes në këtë proces. Sepse ndoshta vetëm në atë humbje të përkohshme, në atë lëvizje të brendshme drejt së panjohurës, zbulojmë veten tonë më të vërtetë. Dhe kur zbulojmë vetveten, është pikërisht atëherë kur fillojmë të rrisim botën, një fëmijë, një ëndërr, një kopsht... një jetë të re.

83 Vjet nga Themelimi i DEBATIK-ut: Kujtesë për Trimërinë e Fëmijëve Shqiptarë

Më 10 shkurt 1942, në kodrat e Saukut, një grup fëmijësh të moshave 10 deri në 14 vjeç, të frymëzuar nga ideali i çlirimit dhe drejtësisë, hodhën themelet e një organizate që do të mbante përherë një vend të veçantë në historinë e luftës antifashiste të popullit shqiptar, Organizata “DEBATIK”.

Emri DEBATIK lindi nga bashkimi i fjalëve: Djemtë e Bashkuar Anëtarë të Idealeve Komuniste, një emër ku reflektohej fryma e kohës, përkushtimi, guximi dhe ndjenja e thellë atdhetare edhe pse në trupat e vegjël të fëmijëve.

Nga Kodrat e Saukut në Historinë Kombëtare – 83 Vjet DEBATIK

Në kulmin e pushtimit fashist italian dhe terrorit që përjetonte populli shqiptar, rinia dhe fëmijët nuk qëndruan mënjane. Pikërisht në këtë kontekst, një grup të rinjsh të varfër, fëmijë punëtorësh, zanatçinjsh dhe nëpunësish modestë të ndikuar nga organizimi i Rinisë Komuniste, vendosën të marrin pjesë aktive në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ata u mbledhën fshehurazi te kodrat e Saukut dhe lidhën një betim solemn përpara flamurit: t’i qëndrojnë besnik Atdheut, të luftojnë pushtuesin dhe bashkëpunëtorët e tij, dhe të mos tradhetojnë kurrë njëri-tjetrin.

Anëtarët themelues

Në atë mbledhje historike të 10 shkurtit 1942, ishin të pranishëm: Ahmet Godenca, Ali Anadolli, Agim Kalo, Agim Tugu, Bardhyl Erebara, Gaqo Merko, Gëzim Erebara, Perlat Bozgo, Petrit Mëzezi, Musa Anadolli, Selman Vaqari, Xhevat Bizgo.

Këta fëmijë u shndërruan në simbol të guximit të hershëm, në një moshë kur zakonisht luftohet me ëndrra, por ata luftuan me bindje dhe aksion kundër një pushtuesi të pamëshirshëm.

Roli në luftë

Organizata “DEBATIK” shërbente si një hallkë ndërlidhëse mes organizatës së Rinisë Komuniste dhe strukturave të tjera të luftës. Anëtarët e saj kryenin detyra të rëndësishme si shpërndarje të trakteve, njoftim i lëvizjeve të armikut, ndihmë për partizanët, dhe ruajtje e sekretit me përkushtim të madh. Shumë nga këta fëmijë ranë dëshmorë, një prej tyre ishte Perlat Rexhepi, simbol i sakrificës së fëmijëve në shërbim të atdheut.

Spiunët e shumtë në shërbim të nazifashistëve, binin në gjurmë të tyre. Shumë debatikas u burgosën e u torturuan, por qëndresa e tyre ishte heroike. Nazistët nuk kursyen torturat në trupin e njomë në kampin famëkeq të Prishtinës. Nazifashistët dhe ballistët nuk kursyen torturat në trupin e njomë në kampin famëkeq të Prishtinës ndaj debatikasve Bojka, Nysreti dhe Meti. Liri Krojin e arrestuan në rrugë. Në xhep kishte një letër me rëndësi për shokët kryesorë, e futi në gojë dhe e gëlltiti.

Debatikasit, në korrik 1943, pasi kishin dhënë shfaqje artistike në lagjet e Tiranës, shfaqën në Priskë komedinë “Prefekti”, e cila më vonë e ripunuar u dha, me dhjetëra e dhjetëra herë. Kjo bëhej shkak që ata, të largoheshin në terren e në mjaft raste të rroknin armët e të rreshtoheshin në formacionet partizane. Si të tillë mund të përmendim, Lirinë, Veronikën, Adelinën, Ylberën, Musanë, Aristidhin, etj., të cilët, gjatë veprimeve luftarake, u treguan trima e të guximshëm e luftuan deri në çlirimin e Shqipërisë, më 29 Nëntor 1944.

80 debatikas ranë dëshmorë

Është i rrallë heroizmi i pionierëve partizanë, Heronjve të Popullit: Ylberë Bilibashi, që ra duke u kacafytur me nazistët në kodrat e Vokshit, Met Hasës, Çelo Sinanit, që ranë në përleshje me armiqtë. Janë dhjetëra pionierë dëshmorë të Tiranës, që ranë për çlirimin e Atdheut si: Ali Spahiu, Ahmet Godenca, Fiqiri Begeja, Xheladin Hoxha, Agim Gjilani, Aleko Qirici, (Coli i filmit), Jorgo Vogli, Rexhep Skënderi, Irfan Konxholli, Shaqir Hoshafi, Qazim Alimehmeti, Qemal Mehmeti, Osman Ademi, Aristidh Pano, Xhemal Zajmi, Osman Luga, Amali Qenami, Nadire Hysa, etj. Por ka plot

FËMIJË NË MOSHË, HERONJ NË ZEMËR – 83 VJET NGA DEBATIK



ORGANIZATA “DEBATIK” SHËRBENTE SI NJË HALLKË NDËRLIDHËSE MES ORGANIZATËS SË RINISË KOMUNISTE DHE STRUKTURAVE TË TJERA TË LUFTËS. ANËTARËT E SAJ KRYENIN DETYRA TË RËNDËSISHME SI SHPËRNDARJE TË TRAKTEVE, NJOFTIM I LËVIZJEVE TË ARMIKUT, NDIHMË PËR PARTIZANËT, DHE RUAJTJE E SEKRETIT ME PËRKUSHTIM TË MADH.

dëshmorë edhe në rrethe.

Debatikasit përbëjnë një shembull të shkëlqyer frymëzimi për të gjithë brezat. Vepra e DEBATIK-ut do të jetë brez pas brezi e nderuar. Brezi i ri dhe brezat që vijnë le të mësojnë se ç’ bëri brezi i fëmijëve të Luftës. Vërtet ajo ka qenë organizatë e të vegjëlve, por bëri punë të madhe. Ata kishin një këngë që u bë himn i tyre: “Luftoj për Liri, /Me sa kam fuqi, /S’trembem asnjëherë, /Se jam pionier”, jehona e së cilës vjen deri në ditët tona.

Pas çlirimit

Pas çlirimit të Shqipërisë, më 1945, organizata “DEBATIK” u përfshi në Organizatën e Pionierëve të Shqipërisë, duke ruajtur frymën patriotike dhe edukimin me ideale përparimtare. Ajo vazhdoi të mbajë gjallë kujtimin e sakrificës dhe kontributit të brezave të rinj në Luftën Nacionalçlirimtare.

Trashëgimia historike

DEBATIK-u nuk ishte thjesht një organizatë fëmijësh – ishte simbol i ndërgjegjes së hershme revolucionare, dëshmi se dashuria për atdheun dhe urrejtja ndaj pushtuesit nuk njihnin moshë. Sot, në 79-vjetorin e krijimit të saj, nderojmë jo vetëm ata që ishin në mbledhjen e parë, por gjithë ata fëmijë që me guximin dhe shpirtin

e pastër kontribuan në kauzën e lirisë.

Lapidari në Kodrat e Liqenit

Me ndërtimin e Varrezave të Dëshmorëve (1947), në Kodrat e Liqenit u vendos edhe një lapidar për nder të organizatës ‘DEBATIK’ (Djemtë e bashkuar të idealeve komuniste). Memoriali përkujton besëlidhjen e datës 10 shkurt 1942 mes fëmijëve antifashistë të Tiranës nën kujdesin e celulave komuniste. Pikërisht në vendin ku sot ngrihet memoriali, debatikasit propozën materialet më të rëndësishme të organizatës si dhe bënë betimin. Aktiviteti i tyre frymëzoi artistët Hysen Hakani dhe Gëzim Erebara për realizimin e filmit “Debatik”, ku spikati roli i Colit, një nga personazhet më mbresëlënës në kinemanë shqiptare. Shumë skena të filmit janë xhiruar në vendin ku u themelua organizata, te Lapidari në Parkun e Liqenit.

Lapidari, në formën që është sot, u rikonstruktua në vitin 1988. Ky është vendi ku breza të nxënësve të shkollave tetëvjeçare të Tiranës bënë betimin për të aderuar në organizatën e “Fatosit” dhe më të rritur, në atë të “Pionierit”. Për nder të këtij memoriali, në vitin 1961 u realizua filmi “Debatik”.

Lavdi dëshmorëve të DEBATIK-ut!

Lavdi brezave që rritën flakadanin e lirisë që në fëmijëri!



Eduard Demo

Edhe pse jo më në uniformën e gjelbër, kolonel Demo sjell mes publicistikës së tij për brezat e rinj, historinë e lavdishme të popullit shqiptar dhe mes ribotimit, të librit “Drejtimi i ushtarakëve në Luftën Kombëtare të Vlorës”, atë të luftës së Vlorës.

Në një kohë kur shumë heronj të historisë sonë trajtohen në mënyrë romantike, mungonte një vepër që të paraqiste Luftën e Vlorës 1920, jo vetëm si simbol patriotizmi, por si akt strategjik dhe luftarak i mirë planifikuar.

Libri i kolonel Eduard Demos, “Drejtimi i ushtarakëve në Luftën Kombëtare të Vlorës”, vjen si një përgjigje e fuqishme ndaj kësaj mungese, duke i vendosur ushtarakët shqiptarë në vendin që u takon në historinë e fitores.

Kjo nuk ishte një lëvizje spontane, siç shpesh është përshkruar, por një luftë klasike e organizuar sipas të gjitha parimeve të artit ushtarak.

Kolonel Demo, me përvojë si oficer karriere dhe njohës i thelluar i teorisë dhe praktikës ushtarake, dëshmon se përplasja me një superfuqi si Italia kërkonte më shumë se vetëm kurajë: kërkonte strategji, shtabe të mirë përgatitura dhe drejtim të organizuar të trupave.

Në libër përshkruhen me hollësi:

- Planifikimi operacional që parapriu luftimet;
- Analizat e terrenit, njohja e kundërshtarit dhe ndërtimi i manovrave;
- Furnizimi dhe logjistika për mbi 7,000 luftëtarë;
- Kultura e drejtimit ushtarak shqiptar që sfidoi mendësinë kolonialiste të gjeneralëve italianë.

Duke zbërthyer luftën në hallkat e saj, autori tregon se fitorja nuk ishte rastësi. Ishte rezultat i një udhëheqjeje të përgatitur që sfidoi jo vetëm armikun, por edhe perceptimet e gabuara mbi organizimin ushtarak shqiptar.

Ky libër më shumë se një kujtesë historike, është një rikthim i dinjitetit të oficerëve shqiptarë, të cilët për dekada u lanë në harresë nga narrativat e thjeshtuara popullore.

Eduard Demo arrin të ndërtojë një “anatomi” të saktë të luftës, ku përplasja nuk ndodhi mes “barinjve dhe ushtarëve”, por mes dy doktrinave ushtarake, ku fitues doli profesionalizmi, motivimi dhe organizimi shqiptar.

“Drejtimi i ushtarakëve në Luftën Kombëtare të Vlorës”, me autor Eduard Demo, është një kontribut i vyer në literaturën ushtarake shqiptare, i cili pasuron jo vetëm dijen historike, por edhe vetëdijen profesionale për rolin strategjik të lidërshpit ushtarak në fitoret kombëtare.

Për lexuesin e ri pak nga jetëshkrimii autorit të librit “Drejtimi i ushtarakëve në Luftën Kombëtare të Vlorës” kolonel Eduard Demo: Nga viti 1982 deri në Shtator 1993 ka kryer detyrën si Specialist i Përgatitjes Teoriko-Profesionale në FA Kukës dhe Vlorë.

Janar 1983 - qershor 1990, kom. Toge, shef Shtabi Batalioni Artmitralier Shishtavec, shef i stërvitje Brigada Bicaj. Shkurt 1990 - shtator 1993, kom. Batalioni Smokthine Vlorë. Mars 1998 - mars 2002, specialist Logjistike në DPQ Vlorë. Prill 2002 - nëntor 2004, shef i Zyrës Logjistike DPQ Vlorë. Shtator 1999 - dhjetor 2003, Drejtoria e Monumenteve të Kulturës Kujdestar i Qytetit Antik Orik.

Qershor 2006 - janar 2008, administrator i ‘Aulona Pol’ Vlorë. Prill 2008 - 2017, punonjës i Kompanisë “Interalbanian”, dega Vlorë.

Edukimi dhe trajnimi

1974 - 1978, Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Skënderbej” Tiranë.

1979 - 1982 Shkolla e Lartë e Bashkuar “E. Hoxha” Tiranë.

2003 - 2005 Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, dega Biznes -Turizëm.

Mars 2000 - dhjetor 2000: Kualifikim për Monumentet e Kulturës dhe Arkeologjinë, Drejtoria e Muzeve Vlorë.

Rikthimi i një të vërtete të heshtur: Ushtarakët që drejtuan fitoren në Luftën e Vlorës

Publikime

Botim i Librit “Udhëtim në Orikun e Lashtë”, bashkautor, 2002 Tiranë.

“Drejtimi i Ushtarakëve në Luftën Kombëtare të Vlorës 1920”.

Studim - “Marshimi i Batalionit të Këmbësorisë në terren të rënduar nga Dëbora”, revista “Për mbrojtjen e Atdheut”, 1986.

Studim - Shpellat Karstike në Rrethin e Vlorës, bashkëpunim me Novruz Bajramin.

Studim - Një Vendbanim i Vjetër në fshatin Tërbaç.

Emission TV - Eksplorimi i Shpellës së “Parashqevisë”, Dhërmi, me TV Amantia.

Studim - “Elitat në drejtimin dhe zhvillimin e shoqërisë”, gazeta “Rrënjët”.

Studim - “Folklori, Art dhe Histori”, këngë historike, shtypi periodik.

Studim - “Folklori, Art dhe Histori”, këngë trimërie, shtypi periodik.

Studim - “Folklori, Art dhe Histori”, këngë vaji, shtypi periodik.

Studim - Pasuritë Natyrore të Vlorës, Flora dhe Fauna. Studim për Zhvillimin e Turizmit..

Projekte

Pastrimi i liqenit të qytetit Orik, Vlorë + OSBE dega Vlorë.

Kartelizimi i vlerave monumentale Prefektura Vlorë + UNOPS.

Foto-Ekspozitë, Monumentet e Kulturës + Pro HELVETIA.

100 Vjetori i Shkollës së parë Shqipe në Vlorë + Qendra “Vatra”.

Banesa qytetare Vlonjate Guri, Ndërtimi dhe Historiku.

Zbulime

Kavë antike në Drashovicë Vlorë + Novruz Bajrami - Historian.

Banjë të periudhës Romake Kocul Vlorë + Ilia Çano - Arkeolog.

Akademia e Kallorit Qishbardhë Vlorë + Ilia Çano.

Gjatë punës së tij 39 vjeçare, Eduardi ka drejtuar ekipe pune në pozicionin e specialistit por edhe të drejtuesit. Është angazhuar në punë në grup me shoqërinë civile si dhe në angazhimet organizatave Ushtarake të qytetit të Vlorës dhe ato Kombëtare. Gjithashtu Eduard Demo është drejtues i Shoqatës “Grupimi i Ushtarakëve në Lirim dhe Rezervë”.





Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Labinoti, qendër strategjike
Në zonën malore të Shqipërisë së Mesme, që gjendet rreth 10-12 km në verilindje të Elbasanit, shtrihet një lokalitet i vogël, i quajtur Labinot. Fshati Labinot mal, i vendosur në faqe të një mali, siguron mbrojtje të mirë natyrore. Rreth tij, zona e Martaneshit dhe malet e Kaptinës e mbrojnë nga veriu dhe verilindja; në anën perëndimore, përrenjtë malorë përbëjnë një pengesë për t'u afruar, dhe lartësitë që shtriheshin nga jugu, krijojnë kushte për mbajtjen nën vërtetim të rrugës automobilistike Elbasan-Librazhd. Labinoti gjatë vitit 1943, me të gjithë fshatrat përfaqësojti, ishte konsoliduar bazë e fuqishme e Luftës NÇ, ku kishin ndodhur ngjarje të shënuara. Këtu nga 4-10 korrik 1943, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar. Mbledhja analizoi gjendjen politike të brendshme e të jashtme, veprimtarinë e këshillave nacionalçlirimtarë, dhe gjerësisht u ndal sidomos në analizën e luftës të popullit shqiptar kundër pushtuesit. Mbledhja pas një analize të gjendjes reale, arriti në përfundim se ishin kushtet për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm. Në përfundim të mbledhjes, më 4 korrik 1943, vendosi formimin e tij, "...si një qendër organizative, politike e operative e të gjitha fuqive të armatosura antifashiste". Ky organizim i rëndësishëm për LANÇ-in, bëri që Këshilli i Përgjithshëm NÇ dhe Shtabi i Përgjithshëm të shpallnin një proklamata drejtuar popullit shqiptar, më 10 korrik 1943. Kjo ditë ka shënuar dhe krijimin e Ushtrisë NÇSH, dhe ka hyrë në histori si një ditë historike që duhet përkujtuar. Organizimi i Shtabit të Përgjithshëm të Fuqive të Armatosura Nacionalçlirimtare, thuhet në proklamata, është një përgjigje flakë për flakë që po i japim armikut.

Një proklamata me vlera historike
Proklamata, e cila ishte përmbledhja e diskutimeve në mbledhjen e 4 Korrikut, zëbërthe dhe analizonte faktorët që shpënë në krijimin e Shtabit të Përgjithshëm. Analizë e hollësishme u bëhej rrethanave e kushteve të brendshme dhe të jashtme. Zgjerimi dhe zhvillimi i vullshëm i luftës së armatosur, vlerësohej në planin e brendshëm, si faktori kryesor që kushtëzonte krijimin e Shtabit të Përgjithshëm. Përmasat që kishte lufta, bënë të mundur që formacionet partizane të kryejnë operacione të rëndësishme, të cilat "...dërrmuan fuqitë e armikut në të katër anët (Patos, Selenicë, Fushë e Çepelit, Pezë, Gjorm, Libohovë, Përmet, Leskovik etj.) dhe i shtrënguan të mbyllen nëpër qytete. Në analizën e faktorit të brendshëm, rëndësi e veçantë iu kushtua perspektivës së zhvillimit të luftës. Para Shtabit të Përgjithshëm, si organ ushtarak, dolën këto detyra parësore: përsosja e organizimit ushtarak të UNÇSH-së; përpunimi i taktikës së luftës dhe udhëheqja strategjike operative e luftës së armatosur. Plotësimi i tyre do të bënte arritjen e misionit strategjik dhe duke respektuar ligjet e rregullat e luftës.

Proklamata për faktorin e jashtëm theksonte goditjet dërrmuese që kishin marrë hitlerianët nga aleatët; beteja e Stalingradit dhe fitoret e arritura nga forcat anglo-amerikane në Afrikën e Veriut e në Sicili. Kjo situatë jo vetëm favorizonte Lëvizjen Nacionalçlirimtare të popujve që luftonin kundër zgjedhës nazi-fashiste, por njëherazi kërkonte fuqizimin e mëtejshëm të luftës së tyre të armatosur. Prandaj krijimi i Shtabit të Përgjithshëm merrte rëndësi të veçantë dhe në planin ndërkombëtar.

Lufta Nacionalçlirimtare Shqiptare, si pjesë përbërëse e luftës së madhe antifashiste botërore, nuk mund të bashkërendohej si duhej me luftën e shteteve e të popujve pjesëtarë të koalicionit



Enver Hoxha, komisar i Shtabit Madhor dhe disa anëtarë të Shtabit, në Labinot, me oficerë britanikë, korrik 1943.

10 Korriku 1943, Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH: Themeli i Ushtrisë së Rregullt Shqiptare



Shtabi i Përgjithshëm, 10 korrik 1943 (Mungon në foto vetëm Bedri Spahiu)

botëror antifashist pa një shtab drejtues të posaçëm në shkallë kombëtare. Shtabi i Përgjithshëm do të realizonte një koordinim të mirë e të plotë të luftës së popullit tonë në kuadrin e teatrit luftarak të Mesdheut, si dhe me luftën e popujve fqinjë të Ballkanit. Veprimtaria e Shtabit të Përgjithshëm po krijonte kushte për një vlerësim real të luftës së armatosur të popullit shqiptar.

Ideja për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, u hodh në Konferencën e Pezës. Në praktikë u realizua pas nëntë muajsh. Po më parë, a mund të ishte krijuar ky shtab? Analiza e bërë thekson se krijimi i Shtabit ishte rrjedhojë logjike e ndryshimeve të rëndësishme sasiore e cilësore që kishin ndodhur në formacionet partizane dhe në veprimtarinë luftarake të tyre. Formimi i tij u bë i domosdoshëm kur ishte rritur intensiteti i luftës së armatosur dhe i formacioneve partizane të cilat erdhën natyrshëm. Shtabi i Përgjithshëm ishte organi më i lartë i udhëheqjes politike e ushtarake të UNÇSH-së. Lufta e armatosur e popullit shqiptar me krijimin e tij, hyri në një etapë të re zhvillimi, në atë të kryengritjes së përgjithshme popullore. Lufta mori karakter më të organizuar, më të gjerë e më të ashpër. Udhëheqja strategjike e Forcave të Armatosura kundër fashistëve u ngrit në një shkallë më të lartë e më të specializuar.

Struktura e Shtabit të Përgjithshëm

Këshilli i Përgjithshëm NÇ vendosi që ndërtimin e strukturës organizative të Shtabit të Përgjithshëm ta linte në kompetencë të tij. Ndaj dhe Shtabi në mbledhjen e datës 10 korrik, pasi studioi projektin e përgatitur nga komisioni i ngritur prej tij, miratoi strukturën që ishte: shtabi operativ, komisarati politik, komisarati ekonomik, seksioni i brendshëm, seksioni i shëndetësisë etj. Me zgjerimin e luftës, gradualisht në strukturën e Shtabit u shtuan dhe elementë të tjerë, të nevojshëm për veprimtarinë, të cilat ishin: seksioni i informacionit, grupi i specialistëve të ndërlidhjes, të xhenios, njësi i sigurimit të Shtabit etj.

Luftën e armatosur Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së e udhëhoqi kurdoherë si një organ kolegial. Kështu në urdhrin e lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm, më 17 gusht 1943, mbi strukturën organizative në UNÇSH-së, ky kriter gjen shprehjen e vet, ku theksohej se Ushtria Nacionalçlirimtare Partizane dhe Vullnetare vihet nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm. Organet e larta, Komanda e Shtabit të Përgjithshëm, kishte kompetenca të gjera lidhur me përpunimin e planeve strategjike e operative, dhe këto njëkohësisht merrnin vendime të rëndësishme për problemet kryesore të luftës së armatosur e të përsosjes organizative të UNÇSH-së. Në plotësimin e këtyre detyrave, komanda gjithmonë bashkëvepronte me disa nga anëtarët e tjerë të Shtabit, që gjendeshin dhe qëndronin pranë tij.

Shtabi operativ në strukturën e Shtabit, luante dhe kishte rol tepër të rëndësishëm. Ky shtab operativ gjithmonë përbëhej nga komandanti dhe komisar i Shtabit, si dhe dy specialistë ushtarakë. Specialistët ndiqnin situatat luftarake në shkallë vendi, i raportonin Shtabit në bazë të planeve e ideve të tij, si dhe hartoheshin urdhra operacione e udhëzime. Nëpërmjet veprimtarisë të këtij Shtabi operativ, bëhej i mundur drejtimi operativ-strategjik i UNÇSH-së dhe i formacioneve të saj. Ndërsa seksionet si komisarati ekonomik, seksioni i brendshëm

dhe ai i shëndetësisë drejtoheshin e kishin në krye një anëtar Shtabi. Ndërsa shumica e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm mbanin dhe kryenin funksione komanduese në formacionet të ndryshme të UNÇSH-së.

Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së nuk ishte strukturë e rëndë. Në vetvete ai ishte një aparat i lehtë, i gatshëm për lëvizje e manovrime të shpeshta, i përshtatej terrenit malor dhe natyrës të luftës partizane. Shumë nga anëtarët e Shtabit komandonin formacione partizane. Edhe ata anëtarë të Shtabit, të cilët nuk kishin funksione komanduese, shpesh gjendeshin pranë formacioneve të mëdha të UNÇSH-së, në detyrën e deleguar të tij, gjatë operacioneve luftarake. Në çdo vendqëndrim të Shtabit gjatë luftës gjendej komanda dhe dy deri në tre anëtarë të tij. Në këtë mënyrë Shtabi paraqet një tipar të theksuar operativ, gjë që e rriste shumë efektivitetin e veprimit të tij.

Shtabi i Përgjithshëm, në varësi nga zhvillimi i situatave, gjithmonë synonte të ndodhej e të gjendej në afërsi të ngjarjeve e të operacioneve të rëndësishme luftarake. Gjatë luftës ai manovroi kryesisht në zonat e Shqipërisë së Mesme dhe deri në Jug të vendit. Vende të përshtatshme gjithmonë janë vlerësuar krahinat malore, të cilat ishin shndërruar në baza të fuqishme të luftës partizane. Në periudhën korrik 1943-gusht 1944, vendet e qëndrimit e të drejtimit të Shtabit të Përgjithshëm ishin Çermenika (Labinoti, Shmili, Orenja), Kucaka, Panariti, Helmesi, Odriçani. Fund shtatori 1944, Shtabi i Përgjithshëm u përqendrua në qytetin e lirë të Beratit, nga ku drejtoi operacionet mësimëse për çlirimin e plotë të vendit.

Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm

SHP u zgjodh nga Këshilli i Frontit Nacionalçlirimtar. Rëndësi të veçantë merrte përzgjedhja e anëtarëve të këtij shtabi. Njeri grup përbëhej nga ushtarakë të shkolluar e të karrierës, anëtarë të tij ishin Spiro Moisiu, Abaz Kupi, Bedri Spahiu, Dali Ndreu. Këshilli i Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar zgjodhi nga ky grup komandant të Shtabit Spiro Moisiun, me gradën e majorit dhe funksionin e komandantit të batalionit në ushtrinë mbretërore. Ai vinte në këtë detyrë me përvojën e një karriere të gjatë, ku spikasin jo vetëm aftësitë e profesionalizmit ushtarak, por edhe dinjiteti e atdhedashuria. Intellektualët përfaqësueshin nga Sejfulla Malëshova, Enver Hoxha, Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi e Ramadan Çitaku. Enver Hoxha që ishte sekretar i parë i PKSH, zgjidhet në funksionin e komisarit politik të SHP. Anëtarë të Shtabit u zgjodhën dhe prijësit popullorë Haxhi Lleshi, Myslim Peza e Mustafa Xhani. Me autoritetin e respektin që gëzonin në popull, i shndërruan krahinat e tyre Dibrën, Pezën e Martaneshin në baza të fuqishme të luftës së armatosur. Anëtarët e SHP formojnë një galeri portretesh, ku secili me veçoritë e veta, me tipare të ndryshme, dalloheshin në tërësi për aktivitet të pasur patriotik e mbartnin një varg kualitetesh në shumë pikëpamje.

Kujtohet ky shtab në 82-vjetorin historik të krijimit të tij, për vlerat që shfaqti dhe për organizimin dhe drejtimin e luftës me një forcë prej 70.000 luftëtarë të organizuar në 24 BrS, 8 Divizione, 3 Korparmata, një Zonë të Parë Operative, disa komanda qarqesh, vendi dhe roje partizane, si dhe një prapavijë të fuqishme që ishte populli shqiptar.



Shtabi i Ushtrisë Shqiptare

BE-ja ka zbuluar objektivin e saj të ri për klimën, një ulje prej 90% të emetimeve deri në vitin 2040. Por jo të gjitha shtetet anëtare janë dakord, ndërsa një dispozitë për të kontraktuar një pjesë të përpjekjeve për klimën jashtë vendit ka krijuar polemika.

Ndërsa pjesë të mëdha të Evropës janë përfshirë nga një valë rekord nxehtësie, Komisioni Evropian ka propozuar që blloku të zvogëlojë emtimet neto të gazrave serrë me 90% deri në vitin 2040. Kjo është në krahasim me nivelet e vitit 1990 dhe në rrugën e duhur për të përmbushur objektivin e emetimeve neto zero deri në vitin 2050.

Objektivi detyruës për reduktimin e emetimeve u propozua për herë të parë vitin e kaluar dhe erdhi pas muajsh negociatash të vështira midis shteteve anëtare. Objektivi ekzistues kërkon që BE-ja të ulë emtimet neto me të paktën 55% deri në vitin 2030; në maj, Komisioni tha se blloku kishte ulur tashmë emtimet që shkaktojnë ngrohjen e klimës me 37%.

Objektivi i ri do t’u japë siguri investitorëve, “do të forcojë lidhshypin industrial të bizneseve tona dhe do të rrisë sigurinë energjetike të Evropës”, tha komisioni në një deklaratë të mërkurën.

Por jo të gjitha shtetet anëtare janë dakord me planin dhe një klauzolë e diskutueshme fleksibiliteti për blerjen e krediteve të karbonit në tregjet ndërkombëtare ka bërë që aktivistët të ankohen.



“Kreditet e karbonit janë thjesht një mendim magjik”

Sipas propozimit, shtetet anëtare të BE-së mund të blejnë kredite ndërkombëtare karboni në projekte të gjelbra në vendet e treta nga viti 2036 e tutje, duke i përdorur ato për të kompensuar deri në 3% të emetimeve të vitit 1990, të përcaktuara në pikën referuese.

“Kjo mund të ofrojë një rrjet sigurie për të siguruar që një objektiv prej 90% të jetë i arritshëm, ndërsa po i afrohemi neutralitetit klimatik”, - tha komisioni.

Por aktivistët kanë thënë se klauzola e fleksibilitetit u përfshi për shkak të presionit nga shtetet anëtare si Franca dhe Gjermania, së bashku me lobistët kryesorë të industrisë, me koston e investimeve të reduktuara në vend.

Mathieu Mal, një ekspert i klimës dhe bujqësisë në Byronë Evropiane të Mjedisit, tha se klauzola e fleksibilitetit prej 3% ishte një “ide e keqe” për një sërë arsyes.

“Kjo do të thotë se BE-ja do të investonte në vende të tjera jashtë bllokut për të ulur emtimet e tyre, dhe kjo është problematike, sepse ne kemi nevojë për këto investime brenda BE-së. Ne gjithashtu kemi sektorët tanë për të dekarbonizuar dhe kemi nevojë për fonde për transformimin e energjisë këtu”, - tha ai.

“Çdo vend në të gjithë botën duhet të angazhohet për veprime klimatike. Nëse BE-ja i llogarit këto kreditë karboni drejt qëllimeve të veta, atëherë çfarë ndodh me vendet që gjithashtu duhet të ulin emtimet e tyre dhe të arrijnë objektivat e tyre?”

Në maj, Bordi Këshillimor Shkencor Evropian për Ndryshimet Klimatike këshilloi kundër kontraktimit të një pjese të përpjekjeve të bllokut për klimën, duke thënë se kjo “rrezikon devijimin e burimeve nga investimet vendase dhe mund të dëmtojë integritetin mjedisor”. Ai bëri thirrje që i gjithë reduktimi drejt zeros neto të “arrihet përmes veprimeve vendase”.

Kritikët e klauzolës e kanë quajtur atë një dredhi për ndotësit e rëndë që e konsiderojnë të kushtueshme dekarbonizimin në Evropë dhe më të lehtë për të investuar në projekte jashtë vendit që nuk kanë mbikëqyrje të mjaftueshme.

“Përdorimi i krediteve të karbonit është thjesht një mendim magjik për një bllok që nuk është i gatshëm të përmbushë përgjegjësinë e tij për shkakimin e katastrofës klimatike që po përjetojmë tashmë”, - thanë Miqtë e Tokës Evropë. “Kreditet e karbonit kanë një histori të gjatë dështimesh dhe në fund të fundit

Mes valës së fortë të të nxehtit, BE-ja prezanton një objektiv fleksibël për klimën deri në vitin 2040



nuk e ndalojnë Evropën të emetojë më shumë se sa i takon pjesës së saj të drejtë të emetimeve të karbonit”.

Duke folur me DW, Mal theksoi shqetësimet e mëparshme në lidhje me investimet e gjelbra në vendet e treta. “Ka pasur shumë probleme në të kaluarën. Projektet e kryera në disa vende shpesh nuk kanë standarde të larta, ato shpesh mbeten vetëm në letër. Ka pyetje nëse ato janë materializuar ndonjëherë”, - tha ai.

A është ulja e emetimeve prej 90% deri në vitin 2040 shumë ambicioze?

Objektivi i ri i Komisionit ka mbështetjen e të paktën disa prej shteteve anëtare të BE-së. Ndërsa Danimarka merr përsipër presidencën e radhës të BE-së, ajo e ka renditur objektivin e vitit 2040 si një nga prioritetet e saj kryesore. “Kushdo që thotë se transformimi i gjelbër nuk mund të arrihet me ambicie të larta dhe drejtësi sociale në të njëjtën kohë, duhet të vijë në Danimarkë”, - tha Villy Sövnal, një ligjvënës me grupin e të Gjelbërve Evropianë dhe ish-ministër i jashtëm i Danimarkës.

“Konkurrueshmëria në shekullin e 21-të nuk është e lidhur me lëndët djegëse fosile, por me përparimin e tranzicionit të energjisë”, - tha Pedro Sanchez, kryeministri socialist i Spanjës, javën e kaluar në samitin e BE-së në Bruksel.

Por vendet e tjera e konsiderojnë objektivin e vitit 2040 si shumë ambicioz. Italia ka thënë se një objektiv prej 80-85% për vitin 2040 do të ishte më realist, dhe Republika Çeke tha të mërkurën se nuk ishte dakord me propozimin e komisionit.

Duke folur në samitin e BE-së, Presidenti francez Emmanuel Macron tregoi gjithashtu se ishte ende shumë herët për të rënë dakord për vendosjen e objektivit për vitin 2040. “Realiteti është se unë dua ta përcaktoj objektivin tim të vitit 2030 së pari, - tha

ai, dhe të marr kohën demokratike dhe politike për të bindur të tjerët të arrijnë në vitin 2040”.

Ndërsa Gjermania dhe Franca mbështesin klauzolën e fleksibilitetit prej 3%, Franca pret që një përqindje edhe më e lartë e objektivit të përgjithshëm të arrihet duke blerë kredite ndërkombëtare karboni, me disa raporte që sugjerojnë deri në 10%.

85% e evropianëve besojnë se ndryshimi i klimës është serioz Sipas Teresa Ribera, shefes së tranzicionit të gjelbër të BE-së, disa grupe politike në BE vazhdojnë ta mohojnë ndryshimin e klimës, ndërsa të tjerëve u mungon guximi për t’u përballur me zgjedhësit e tyre në lidhje me hapat e nevojshëm për të luftuar problemin.

“Kuraja politike është e nevojshme për të kuptuar se ekziston një vështirësi”, - tha ajo në një intervistë me “The Guardian”. “Duhet ta përballosh me ndershmëri”.

Planet e BE-së për klimën kanë ngritur shqetësime rreth kostove të tranzicionit të gjelbër dhe ndërprerjes së rritjes industriale dhe jetesës, nëse dekarbonizimi kryhet pa mbështetje të mjaftueshme. Megjithatë, Ribera beson se nuk ka kohë për të humbur. “Më vjen keq, por do të jetë shumë më e kushtueshme nëse nuk veprojmë”, - tha ajo.

Sipas një sondazhi të Eurobarometrit të publikuar, 85% e evropianëve besojnë se ndryshimi i klimës është një problem serioz dhe trajtimi i tij duhet të jetë një përparësi, ndërsa 77% ranë dakord se kostoja e dëmit për shkak të ndryshimit të klimës është shumë më e lartë se investimi i nevojshëm për një tranzicion zero neto.

“Ndërsa qytetarët evropianë e ndiejnë gjithnjë e më shumë ndikimin e ndryshimeve klimatike, ata presin që Evropa të veprojë”, - tha të mërkurën Presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen.

Propozimi ende ka nevojë për vulën e miratimit nga Parlamenti Evropian dhe shtetet anëtare, dhe Komisioneri i Klimës Wopke Hoekstra tha se shpresonte që një marrëveshje të mund të arrihej para konferencës së OKB-së për ndryshimet klimatike në Brazil në nëntor. Por koha është e shkurtër dhe ka ende dyshime nëse propozimi në formën e tij aktuale do të miratohet si ligj.



Shtetet e Bashkuara të Amerikës: Eksportuesi më i madh i armëve Nr. 1 globalisht në eksportet e armëve.
Evropa është blerësi më i madh rajonal, duke përbërë 35% të eksporteve të armëve të SHBA-së.
Arabia Saudite është klienti më i madh i vetëm, duke blerë 12% të totalit të armëve amerikane.



Spanja
Spanja është një lojtar relativisht i ri në industrinë globale të armëve. Kombi evropian ishte përgjegjës për 3% të eksporteve globale të armëve. Ky 3% përfaqëson një rritje prej 29% gjatë periudhës midis viteve 2015 dhe 2019.



Izraeli
Pavarësisht konfliktit, Izraeli mbetet një lojtar kryesor në industrinë e armëve, me 3.1% të eksporteve globale të armëve. Izraeli është i njohur për dronët dhe sistemet e tij të mbrojtjes nga raketat, të cilat tërheqin klientë nga e gjithë bota.
India dhe Azerbajxhani janë ndër klientët më të mëdhenj të Izraelit.



Mbretëria e Bashkuar
Mbretëria e Bashkuar kishte një pjesë tregu prej 3.6% të eksporteve globale të armëve në periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2024.
Mbretëria e Bashkuar është një nga eksportuesit kryesorë të avionëve luftarakë dhe raketave, shumë prej të cilave u shiten aleatëve të NATO-s dhe kombeve në Lindjen e Mesme.
Mbretëria e Bashkuar shpenzoi 2.3% të PBB-së së vendit për mbrojtje në vitin 2024, por qeveria ka njoftuar angazhimin e saj për ta rritur këtë numër gjatë viteve të ardhshme.

Eksportuesit më të mëdhenj të armëve



Italia
Italia është një nga eksportuesit më të mëdhenj të armëve në botë, me një total prej 4.8% të pjesës globale. Vendi evropian pati një rritje të madhe prej 138% në pjesën e tij të tregut krahasuar me periudhën e mëparshme trevjeçare.
Marrëveshjet e mëdha me vende si Egjipti dhe Katari kontribuan në pozicionin e Italisë në renditjen e eksportuesve të armëve.



Gjermania
Gjermania renditet në vendin e pestë, me 5.6%. Kjo është një rënie prej 2.6% krahasuar me periudhën e mëparshme.
Që nga viti 2022, kombi e ka përqendruar mbështetjen e tij në Ukrainë dhe mbrojtjen e aleatëve të Evropës dhe NATO-s, duke ulur eksportet ndërkombëtare. Gjermania ende ka një nga buxhetet më të mëdha të mbrojtjes në botë, i cili në vitin 2024 ishte rreth 88.5 miliardë dollarë amerikanë.



Kina
Kina vjen e dyta në listë, me 5.9% të totalit të eksporteve globale. Kjo është një rënie prej 5.4% krahasuar me periudhën e mëparshme (2015 deri në 2019).

Kina eksporton armë në një numër vendesh, përfshirë Tajlandën dhe Serbinë, dhe tani po shfaqet si një alternativë me kosto më të ulët për blerësit në Perëndim. Klienti më i madh i Kinës është Pakistani. Ky vend përbën 63% të të gjitha eksporteve të armëve kineze.



Rusia
Rusia renditet në tre vendet e para, edhe pse aktualisht është e përfshirë në një konflikt dhe e goditur nga sanksionet. Rusia ka 7.8% të pjesës së tregut global, një rënie prej 64% nga periudha e mëparshme. Rusia ende renditet ndër tregtarët kryesorë të armëve, me vende të tilla si India si klientë. Kombi përfaqëson 38% të eksporteve ruse të armëve. Një tjetër klient i madh i armëve ruse është Kina. Vendi aziatik përfaqëson një pjesë të tregut prej 17%.



Franca
Kombi evropian është në vendin e dytë, kur bëhet fjalë për eksportet e armëve. Franca eksporton gjithsej 9.6% të të gjitha armëve në nivel global. Ky numër është rritur nga periudha 2015-2019, kur Franca ishte përgjegjëse për 8.6% të eksporteve. India mbetet klientja më e madhe e Francës, duke përfaqësuar një total prej 28% të të gjitha eksporteve të armëve. Klientë të tjerë të mëdhenj përfshijnë Greqinë dhe Katarin.



Shtetet e Bashkuara
SHBA-të janë padyshim tregtari më i madh i armëve në botë. SHBA-të dominojnë tregun me 43% të të gjitha eksporteve të armëve në periudhën midis viteve 2020 dhe 2024. Vendi eksportoi armë në 107 vende në total. Eksportet totale u rritën me 21% krahasuar me periudhën e mëparshme nga viti 2015 deri në vitin 2019. Evropa mbetet blerësi kryesor i SHBA-së, me rreth 35% të pjesës së tregut. Arabia Saudite është importuesi më i madh i armëve amerikane, me 12%. Burimet: (Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve për Paqen në Stokholm) (Ekonomia Gjeopolitike) (24/7 Wall St.)



Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura!

Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve
për ushtarë/detarë aktiv

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri, më 29 gusht 2025

Apliko në • <https://shorturl.at/p6gNO>